




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCIVE

Raporti Vjetor i Monitorimit Menaxhimi i Financave Publike 2024



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i monitorimit

Ky raport vjetor i monitorimit për zbatimin e reformave të Menaxhimit të Financave Publike mbulon periudhën nga 1 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2024. Ai përshkruan ecurinë e aktiviteteve të reformave të planifikuara dhe arritjet kundrejt treguesve të performancës dhe objektivave të përcaktuara në strategjinë e re sektoriale të MFP-së për periudhën 2023-2030 dhe planin e veprimit për vitet 2023-2026. Strategjia sektoriale e MFP-së është e harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE), Udhërrëfyesin e Reformës së Administratës Publike, Programin e Reformave Ekonomike dhe axhendën më të gjerë të Integritimit Evropian. Strategjia dhe plani i veprimit u miratuan zyrtarisht me VKM nr. 390, datë 12 qershor 2024, “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të MFP-së 2023-2030”.

Strategjitë nën sektoriale

Gjatë periudhës raportuese, plani i veprimit të MFP-së u zbatua krahas disa strategjive nën sektoriale, duke përfshirë draft Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave, Strategjinë e Biznesit të Administratës Doganore të Shqipërisë, Strategjinë e Prokurimit, Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit dhe Strategjinë e Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH).


Bashkëpunimi me partnerët e zhvillimit


Qeveria mbajti bashkëpunimin produktiv me partnerët e zhvillimit për zbatimin e strategjisë. Kjo përfshinte vlerësime të rregullta për të vlerësuar gjendjen e politikave dhe sistemeve të MFP-së, të tilla si konsultimet nën Nenin 4 të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe përgatitjen e një Raporti të Vlerësimit të Performancës lidhur me Llogaridhënien për Shpenzimet dhe Financat Publike (PEFA), si dhe një vlerësim mbi Parimet e Administratës Publike me SIGMA-n. Shumë projekte asistence teknike dhe mbështetjeje të financuara nga partnerët e zhvillimit vazhdojnë të forcojnë sistemet e MFP-së, me partnerët kryesorë si FMN, Banka Botërore, BE, SIGMA dhe SECO.

Ecure e përgjithshme

Plani i veprimit të MFP-së për vitin 2024 përfshin 53 tregues të performancës dhe 130 aktivitete të shpërndara në gjashtë shtylla. **Zbatimi i planit të veprimit është në rrugën e duhur**, me 101 nga aktivitetet e planifikuara për vitin 2024 të përfunduara ose duke përparuar sipas parashikimeve, dhe shumica e objektivave të treguesve të performancës janë arritur, siç paraqitet në grafikët e mëposhtëm.

Grafiku 1. Statusi i objektivave të treguesve të performancës



Grafiku 2. Statusi i aktiviteteve**Zhvillimet kryesore të shtyllave****Shtylla 1: Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut**

Ministria e Financave (MF) ka ruajtur dhe ka përmirësuar sistemet për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të shëndosha fiskale, të udhëhequra nga rregullat fiskale, parashikimet e forta makroekonomike dhe menaxhimi solid i risqeve fiskale. Pajtueshmëria me rregullat fiskale është raportuar në mënyrë transparente në dokumentet kryesore, përfshirë ‘Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal’, ‘Programin e Reformave Ekonomike’ dhe ‘Raportin mbi Zbatimin e Buxhetit Vjetor të Situatës Makroekonomike dhe Fiskale’. Rregullat fiskale për parashikimin e PBB-së nominale dhe bilancin primar janë zbatuar plotësisht. Veprimi për asistencën e parë teknike (trajnim) mbi krijimin e kuadrit për Analizën e Qëndrueshmërisë së Borxhit është përfunduar. Gjatë vitit 2024, u finalizua përgatitja e Deklaratës së Risqeve Fiskale për vitin fiskal 2023. Dokumenti i finalizuar, i miratuar nga Ministri i Financave, i është paraqitur zyrtarisht Këshillit të Ministrave, për qëllime informuese. Është përgatitur një dokument teknik me opsione për krijimin e një Këshilli Fiskal.

Shtylla 2: Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent

Përputhshmëria e dokumenteve të reja strategjike me Udhëzimet e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) është përmirësuar ndjeshëm. Janë hartuar metodologjitë për buxhetimin e gjelbër dhe analizën e hendeut gjinor. Janë përfunduar procedurat dhe rregulloret për seancat e brendshme dëgjimore buxhetore midis MF dhe Institucioneve Buxhetore, si dhe për pjesëmarrjen e publikut në procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA). Miratimi i Dokumentit të Politikave Prioritare (DPP) së bashku me Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP) është përfunduar plotësisht. Procedurat për Menaxhimin e Investimeve Publike janë përmirësuar. Në përputhje me objektivin për forcimin e NSPP-së dhe rritjen e rolit “gatekeeper” të Ministrisë së Financave, janë bërë ndryshime në VKM nr. 887/2022, me anë të VKM nr. 70, datë 14.02.2024. 80% e bashkive kanë përdorur Sistemin e ri për Menaxhimin e Buxhetit Vendor (SMBV). Në vitin 2024, sistemi i ri online po përdoret nga shumica e Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore (NjVV). Sa i përket publikimit të Raporteve të Ekzekutimit të Buxhetit për Qytetarët, janë finalizuar formatet. Lidhur me numrin e kontratave PPP të mbuluara në raportin vjetor të përmbledhur për PPP-të dhe të kontratave koncesionare, për vitin 2024 pritet të përfshihen më shumë sesa në raportin e vitit të kaluar (2023), konkretisht mbi 135 kontrata koncesionare.

Shtylla 3: Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave

U miratua një Strategji e re Afatmesme e të Ardhurave. Të ardhurat nga TVSH-ja janë rritur nga 1.98% e PBB-së në vitin 2023 në 2.39% të PBB-së në vitin 2024. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka reduktuar hendekun e pajtueshmërisë me TVSH-në dhe ka ulur punën e nën-deklaruar dhe atë të padeklaruar. Përdorimi i kanalit të gjelbër u rrit nga 27.9% në vitin 2023 në 30.73% në vitin 2024. Koha e përpunimit të deklaratës doganore është ulur nga 99.1 minuta në vitin 2023 në 90 minuta në vitin 2024. Numri i Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar është rritur nga 13 në vitin 2023 në 16 në vitin 2024. Sa i përket ligjit për taksën mbi pasurinë e paluajtshme dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij, bazuar në VKM nr. 818/2024, projektligji parashikohet të paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025. Pasi projektligji të miratohet dhe të hyjë në fuqi, do të vijojë hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore përkatëse. Janë zhvilluar module shtesë për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Tarifave. Është kontraktuar një kompani për të nisur zhvillimin e një sistemi informatik për Dritaren e Vetme Kombëtare.

Shtylla 4: Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit

Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit ka treguar përmirësim të ndjeshëm, me shumicën e objektivave të Treguesve të Performancës të planifikuara për vitin 2024 të arritura. Aksesi i Institucioneve Buxhetore në Arkivin Elektronik ka tejkaluar pritshmëritë, me një numër shtesë prej 144 institucionesh të reja. Përqindja e kontabilistëve të qeverisë që kanë përfunduar trajnimet për SNKSP është përmirësuar, me 380 auditues të brendshëm të sektorit publik të trajnuar mbi parimet dhe konceptet bazë të kontabilitetit në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara bazuar në SNKSP, si pjesë e zhvillimit të tyre profesional të vazhdueshëm. Plani Vjetor i Huamarrjes dhe Raporti i Monitorimit të SMB janë përgatitur dhe publikuar, dhe norma e saktësisë së parashikimit mujor të likuiditetit është konsoliduar. Për herë të parë, në vitin 2024, parashikimi i likuiditetit përfshin 6 zëra të detajuar hyrës dhe 4 zëra të detajuar dalës. Numri i instrumenteve për menaxhimin aktiv të likuiditetit është rritur me 2 instrumente. U miratua më 04 tetor 2024 udhërrëfyshi “Oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto – MEAT bazuar në kosto”. APP ka rishikuar dhe ndryshuar kuadrin rregullator, konkretisht Udhëzuesin për prokurimin e gjelbër “Për zbatimin e Prokurimit Publik të Gjelbër në Procedurat e Prokurimit Publik” dhe metodologjinë “Për zbatimin e Prokurimit Publik të Gjelbër në Shqipëri”, të cilat janë miratuar dhe publikuar.

Shtylla 5: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik

Të gjitha objektivat e Treguesve të Performancës të përcaktuara për MFK-në u arritën plotësisht në vitin 2024. Ministria e Financave / DHMFKK ka vijuar të përmirësojë kuadrin ligjor dhe rregullator për MFK-në. Manuali i MFK-së dhe disa udhëzime u ndryshuan në janar 2024. Për më tepër, metodologjia e vlerësimit të cilësisë së Kontrollit të Brendshëm u rishikua dhe u miratua në tetor 2024, ndërsa udhëzimi për koordinatorin e riskut dhe koordinatorin e MFK-së u ndryshua në dhjetor 2024. Ministria e Financave ka mbështetur institucionet publike në forcimin e llogaridhënies menaxheriale dhe menaxhimit të riskut, duke sjellë rritje të pajtueshmërisë me kërkesat e MFK-së. Në vitin 2024, procesi i vlerësimit të cilësisë u krye në 20 njësi të qeverisjes së përgjithshme dhe asistencë teknike u ofrua në 5 prej tyre, duke u finalizuar në 4 njësi. Ngritja e kapaciteteve dhe rritja e ndërgjegjësimit kanë qenë një fokus kryesor për MF/DHMFKK në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Pas ndryshimit të ligjit për auditimin e brendshëm, është bërë progres i rëndësishëm në mbikëqyrjen dhe zgjerimin e shërbimeve mbështetëse për institucionet publike dhe për ekipet e auditimit të brendshëm. Ministria e Financave ka vijuar të mbështesë profesionalizimin e praktikave thelbësore të auditimit të brendshëm përmes hartimit të udhëzuesve dhe ofrimit të aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve. Tre Komitete Auditimi funksionale u krijuan në vitin 2024 me synim forcimin e qeverisjes së mirë dhe ofrimit të garancive shtesë për pavarësinë e auditorëve të brendshëm. Po punohet drejt profesionalizimit të praktikave thelbësore të auditimit të brendshëm.

përmes zhvillimit të udhëzuesve dhe ofrimit të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve. Inspektimi Financiar Publik dhe Shërbimet e Koordinimit kundër Mashtrimit, me mbështetje teknike nga ekspertë në kuadër të projektit për Qeverisjen e Mirë, kanë përgatitur draftin e Strategjisë Kombëtare kundër Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, një kuadër strategjik që përfshin një plan veprimi, tregues të përcaktuar qartë dhe vlerësime të kostos për aktivitetet e propozuara. Kjo strategji përcakton hapat e nevojshëm për zbatimin e masave të identifikuar dhe arritjen e rezultateve të synuara. Strategjia pritet të përfundojë dhe të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2025. Sa i përket Menaxhimit të fondeve të BE-së, të gjitha paketat për marrjen e besimit IPA III për Programet e Veprimit Vjetor IPA 2022 dhe tre Programet Operacionale janë miratuar nga KE në vitin 2024. Është bërë progres drejt zhvillimit dhe zbatimit të rregulloreve, procedurave për menaxhimin e IPA III dhe forcimit të kapaciteteve të strukturave IPA III. Manualët e Procedurave të strukturave janë finalizuar dhe miratuar zyrtarisht me Vendim të Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA). Vlerësimi i Nevojave për Trajnim për vitin 2024 u rishikua për të krijuar një listë paraprake temash, e ndjekur nga takime për mbledhjen e pyetësorëve online të lançuar në tetor 2024. Gjetjet paraprake janë marrë dhe organet IPA kanë dhënë input për planin përfundimtar të trajnimit, i cili parashikohet të finalizohet deri në fund të janarit 2025.

Shtylla 6: Mbikëqyrja e Jashtme

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), në përputhje me strategjinë e tij të zhvillimit, vazhdoi të përmirësojë më tej kontrollin efektiv të institucioneve publike, duke zgjeruar mbulimin dhe standardet e auditimit për të siguruar mbikëqyrje të plotë të proceseve financiare dhe për të forcuar praktikën e ndjekjes së auditimit të jashtëm, thelbësore për ruajtjen e llogaridhënies dhe transparencës në praktikën e menaxhimit financiar. Konkretisht, metodologjia për auditimin e PPP-ve dhe koncesioneve u miratua në dhjetor 2024, e cila përcakton qasjen e auditimit për PPP-të, duke mbuluar të gjitha fazat e procesit, nga studimi i fizibilitetit deri te zbatimi i kontratës dhe monitorimi, duke përfshirë gjetjet e fituara nga tre auditimet pilote të kryera gjatë projektit. Në vitin 2024, KLSH realizoi një Vlerësim të Nevojave për të mbështetur miratimin e Politikës së Menaxhimit të Cilësisë, e cila përfshin procedura dhe udhëzime të përmirësuara për cilësinë e auditimit dhe u publikua në faqen zyrtare të KLSH-së. Gjithashtu, KLSH miratoi udhëzuesin për hartimin e raporteve, rishikoi procedurat e auditimit dhe zgjeroi mjetet e komunikimit. Paralelisht, Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat po përparon në mënyrë aktive drejt përmirësimit të shqyrtimit legjislativ të raporteve të auditimit me mbështetjen e disa partnerëve të zhvillimit. Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat realizoi një rishikim institucional me partnerë ndërkombëtarë për të forcuar kapacitetet e tij në fusha si shqyrtimi i buxhetit të shtetit, mbikëqyrja e borxhit publik dhe menaxhimi i financave publike. Një nga arritjet kryesore për vitin 2024 ishte krijimi i nënkomisionit parlamentar për auditimin e sektorit publik, me mbështetjen e Institutit Kombëtar Demokratik (IKD).

Menaxhimi i riskut

Risqe të shumta janë materializuar ose janë identifikuar, që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e planit të veprimit. Këto përfshijnë numrin e pamjaftueshëm të burimeve njerëzore të kualifikuara, kapacitetin e ulët të burimeve njerëzore ekzistuese dhe lëvizjen e stafit, mungesën e koordinimit dhe angazhimit të palëve të interesit, zhvillimin e TI dhe prokurimin, si dhe vonesat në hartimin dhe miratimin e ndryshimeve ligjore. Masat e ndërmarra dhe të planifikuara për t'iu përgjigjur këtyre risqeve përfshijnë hartimin dhe zbatimin e planeve të rekrutimit dhe trajnimit, përmirësimin e bashkërendimit dhe komunikimit me partnerët dhe palët e interesit, si dhe monitorimin e ngushtë të procedurave për prokurimin dhe ndryshimet ligjore.

Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	2
1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I ZBATIMIT TË STRATEGJISË 2023-2030	7
1.1 HYRJE	7
1.2 METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	7
1.3 VIZIBILITETI DHE KONSULTIMET E MFP-SË	7
2 ECURIA E STRATEGJISË NË 2024.....	8
2.1 ARRITJET NË ZBATIMIN E SHTYLLAVE TË STRATEGJISË MFP PËR 2024.....	8
2.2 NDIKIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË MFP-SË NË PËRPUTHJE ME AXHENDËN E INTEGRIMIT EVROPIAN	9
2.3 NDIKIMI I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT NË RAJON DHE/OSE MË GJERË	12
2.4 AKTIVITETET E SHTYLLAVE QË NUK PËRPARUAN SIPAS PLANIT	13
2.5 ZBATIMI I BUXHETIT TË PËRGJITHSHËM	14
3 PROGRESI NË ZBATIMIN E SHTYLLAVE TË STRATEGJISË SË MFP-SË.....	14
3.1 PROGRESI NË SHTYLLËN 1 “PROGRAMIMI MAKROEKONOMIK DHE MONITORIMI I RISKUT”	14
3.2 PROGRESI NË SHTYLLËN 2 “PLANIFIKIMI I INTEGRUAR STRATEGJIK DHE BUXHETOR, MONITORIMI DHE RAPORTIMI TRANSPARENT”	18
3.3 PROGRESI NË SHTYLLËN 3 “MENAXHIMI DHE MOBILIZIMI I TË ARDHURAVE”	26
3.4 PROGRESI NË SHTYLLËN 4 “KONTABILITETI DHE MENAXHIMI I ZBATIMIT TË BUXHETIT”	31
3.5 PROGRESI NË SHTYLLËN 5 “KONTROLI I BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK”	39
3.6 PROGRESI NË SHTYLLËN 6 “MBIKËQYRJA E JASHTME”	46
4 RISQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE.....	49
5 KOSTOJA E STRATEGJISË TË MFP-SË	53
6 PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET.....	54
ANEKS 1: STATUSI I MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT TË MFP	58

1 Vështrim i përgjithshëm i zbatimit të Strategjisë 2023-2030

1.1 Hyrje

Ky është Raporti i dhjetë Vjetor i Monitorimit për Zbatimin e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (MFP), që mbulon periudhën nga 1 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2024. Ai përfshin një vit tjetër përpjekjesh reformuese dhe i ofron informacion të detajuar Komitetit Drejtues dhe Komitetit Teknik të MFP-së mbi progresin e arritur dhe sfidat e hasura në përmbushjen e objektivave dhe masave të strategjisë.

Ky raport ofron një vlerësim të kriterëve të pranueshmërisë së MFP-së në mënyrë që Bashkimi Evropian (BE) të ofrojë mbështetje buxhetore për Shqipërinë, si dhe për Agjendën e Reformave. Kriteri i pranueshmërisë së MFP-së kërkon ekzistencën e një programi të besueshëm dhe relevant për të përmirësuar menaxhimin e financave publike si dhe progres të kënaqshëm në zbatimin e programit. Në vetë-vlerësimin tonë, progresi i MFP-së ka qenë në përgjithësi i kënaqshëm, me 84.91% të treguesve të synuar të performancës të arritur dhe pjesërisht të arritur, si dhe 77.69% të aktiviteve të përfunduara plotësisht dhe në rrugën e duhur.

Qeveria e Shqipërisë (QSh) ka bërë progres të mirë në zbatimin e Strategjisë së Reformave të Menaxhimit të Financave Publike. Zhvillimet për secilën shtyllë janë përshkruar në seksionet e mëposhtme.

1.2 Metodologjia e monitorimit

Drejtoria e Strategjive të Financave Publike dhe Mbështetjes Buxhetore udhëheq procesin e përgatitjes së raportit vjetor të monitorimit të MFP-së dhe dërgon kërkesën për raportim tek të gjithë drejtuesit e shtyllave, që janë strukturat drejtuese përgjegjëse për raportimin e zbatimit të strategjisë kundrejt planit të veprimit të kostuar, performancës ndaj objektivave; çdo vonese; ose ndryshimesh, identifikimit të risqeve të materializuara, risqeve të reja dhe masave zbutëse. Ky raport është përgatitur në bazë të instrumentit të monitorimit të miratuar nga Komiteti Drejtues nr. 11, datë 7 prill 2020, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)”. Struktura e raportit vjetor të monitorimit për vitin 2024 është hartuar në përputhje me metodologjinë IPSIS, bazuar në VKM nr. 290, datë 11.4.2020.

Vlerësimi i progresit të MFP-së bëhet në dy nivele: niveli i arritjeve të treguesve të performancës dhe niveli i aktiviteve. Për sa i përket vlerësimit të treguesve të performancës, metodologjia e përdorur është: TP është shënuar me ngjyrë të gjelbër dhe emërohet si i arritur nëse ka arritur objektivin 2024 sipas planit. TP shënohet me të kuqe nëse TP nuk e ka arritur objektivin e vitit 2024 sipas planit. Në raste të tjera, TP shënohet me të verdhë dhe konsiderohet pjesërisht i arritur. Sa i përket vlerësimit në nivel aktiviteti: me të gjelbër janë ato aktivitete të cilat kanë filluar në vitin 2023 ose 2024 dhe kanë përfunduar sipas planit brenda vitit 2024; me ngjyrë blu janë ato aktivitete të cilat kanë filluar në vitin 2023 ose 2024, janë në rrugën e duhur sipas planit gjatë këtyre viteve, por data e përfundimit është përtej vitit 2024 (me përjashtim të atyre aktiviteve objektivat e të cilave planifikohen periodikisht, në këto raste janë konsideruar si të përfunduara për atë vit dhe janë shënuar me të gjelbër); me të verdhë janë ato aktivitete të cilat pavarësisht datës së përfundimit, janë pjesërisht në rrugën e duhur sipas planifikimit për vitin 2024; dhe me të kuqe janë ato aktivitete që nuk kanë filluar ende; dhe “Nuk kanë ecur” janë ato aktivitete që nuk kanë progres të mirë dhe janë mundësisht në rrezik dështimi.

1.3 Vizibiliteti dhe konsultimet e MFP-së

Strategjia e Reformës së MFP-së shërben si kuadër për dialogun strategjik për të gjithë donatorët dhe aktorët e shoqërisë civile aktive në këtë sektor. Kuadri institucional për menaxhimin e reformave të MFP-së përbëhet nga Komiteti Drejtues (KD), Komiteti Teknik dhe Drejtoria për reformën e MFP-së.

Dy mbledhje të Komitetit Drejtues të MFP-së dhe një mbledhje e Komitetit Teknik u mbajtën gjatë vitit 2024. Më 3 maj 2024 u organizua Komitetit Drejtues i Menaxhimit të Financave Publike. Pjesë e këtij komiteti ishin të gjithë aktorët e përfshirë në planifikimin e reformës së MFP-së (anëtarët e Komitetit Teknik dhe Komitetit Drejtues), partnerët ndërkombëtarë dhe përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile. Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 u miratua me VKM nr. 390, datë 12.06.2024 dhe u publikua në Fletoren Zyrtare më 26.06.2024 si dhe në faqen zyrtare të MF-së. Më 10 tetor 2024 u organizua Komiteti Teknik i 12-të i Menaxhimit të Financave Publike. Në fokus të takimit ishte diskutimi i draft raportit vjetor të monitorimit të MFP-së për vitin 2023, sfidat dhe progresi i arritur, si dhe diskutimi i raporteve vlerësuese nga partnerët ndërkombëtarë. Më datë 31 tetor 2024, draft raporti u diskutua dhe u miratua në mbledhjen e 18-të të Komitetit Drejtues të MFP-së dhe u publikua në faqen zyrtare të MF-së¹. Komiteti Drejtues i MFP-së u kryesua nga Ministri i Financave. Në takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve dhe drejtorive të MF-së të përfshirë në MFP dhe anëtarë të tjerë të Komitetit Drejtues, si dhe partnerë për zhvillim dhe organizata të shoqërisë civile.


Më 20 qershor 2025 u organizua Komiteti Teknik i 13-të i Menaxhimit të Financave Publike. Në fokus të takimit ishte diskutimi i draft raportit vjetor të monitorimit të MFP-së për vitin 2024, sfidat dhe progresi i arritur, si dhe diskutimi i raporteve vlerësuese nga partnerët ndërkombëtarë. Më 11 nëntor 2025, draft raporti u diskutua dhe u miratua në mbledhjen e 19-të të Komitetit Drejtues të MFP-së dhe do të publikohet në faqen zyrtare të MF-së. Komiteti Drejtues i MFP-së u kryesua nga Zëvendësministri i Financave. Në takim morën pjesë të gjithë aktorët e përfshirë në planifikimin e reformës së MFP-së (anëtarët e Komitetit Teknik dhe Komitetit Drejtues), partnerët ndërkombëtarë dhe përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile. Në kuadër të transparencës dhe komunikimit me publikun, MF publikon në faqen e saj zyrtare çdo raport vjetor monitorimi në gjuhën shqipe dhe angleze.

2 Ecuria e Strategjisë në 2024

2.1 Arritjet në zbatimin e Shtyllave të Strategjisë MFP për 2024

Qeveria e Shqipërisë ka bërë progress të mirë në zbatimin e Strategjisë së Reformave të Menaxhimit të Financave Publike. Progresi i MFP-së ka qenë në përgjithësi i kënaqshëm, me 84.91% të treguesve të synuar të performancës të arritur plotësisht. Në përgjithësi, grafiku më poshtë paraqet një vështrim të nivelit të arritjeve për secilin shtyllë, në nivelin e treguesve të performancës.

Grafiku 3. Niveli i arritjeve të TP-ve për secilën shtyllë



¹ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2025/01/2023-PFM-Annual-Monitoring-Report.pdf>

Gjatë vitit 2024, u arriten objektivat e mëposhtme të treguesve të performances: (1) Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) Nominal: diferenca e vlerave të parashikuara ndërmjet MF-së dhe FMN-së nuk duhet të jetë më e madhe se zero; (2) Balanca Primare: duke filluar nga viti 2024, Balanca Primare do të mandatohet ligjërisht si rregull i ri fiskal dhe parashikohet të jetë jo më pak se zero; (3) Përfundimi i asistencës teknike për Analizën e Qëndrueshmërisë së Borxhit; (4) Prezantimi i Deklaratës Vjetore të Riskut Fiskal; (5) Krijimi i Këshillit Fiskal; (6) Përqindja e strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara në përputhje me udhëzimet e SPI-së; (7) Treguesi SIGMA 6.7.1 – Funksionimi i kontrollit të brendshëm (Lidhja ndërmjet strukturave menaxheriale dhe buxhetore (%)); (8) Prezantimi i analizës së hendekut gjinor si pjesë e BPGJ-së; (9) Prezantimi i buxhetimit të gjelbër të përgjigjshëm ndaj ndryshimeve klimatike; (10) Miratimi i Dokumentit të Politikave së bashku me Listën Unike me Rëndësi Kombëtare; (11) Prezantimi i procedurave të përmirësuara të MIP-së (përfshirë mekanizmat përkatës të vendimmarrjes; (12) Pjesa e projekteve të investimeve publike që propozohen në bazë të prioritetëve strategjike të qeverisë (vlera e projekteve në një vit të caktuar); (13) Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime; (14) Raporti i investimeve të reja publike të paraqitura brenda ciklit të PBA-së kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit; (15) Formula e grantit e rregulluar bazuar në të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë; (16) Përqindja e bashkive që përdorin software-in e ri SMBV; (17) Prezantimi nga MF i Software-it të Menaxhimit të Buxhetit Vendor dhe E-Platformës; (18) Publikimi i raporteve të zbatimit të buxhetit për qytetarët; (19) Numri i kontratave PPP të mbuluara në raportin vjetor të përmbledhur për PPP-të dhe kontratat koncesionare; (20) Rritja e të hyrave nga SSA (në total nga administrata tatimore dhe doganore sipas SAA-së); (21) Miratimi i SAA; (22) Rritja e të hyrave nga TVSH-ja (e matur në bazë jokumulative); (23) Rritja e të ardhurave nga reduktimi i punës së nëndeclaruar dhe të padeclaruar (e matur në bazë jokumulative) si rezultat i futjes së 40 mijë punonjësve të rinj në skemë dhe rritja e deklarimit të pages së 120 mijë punonjësve, sipas kalendarit të rritjes në SAA; (24) Përqindja e shfrytëzimit të Kanalit të Gjelbër; (25) Koha e përpunimit të deklaratës doganore; (26) Numri i Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar; (27) Numri shtesë i Institucioneve Buxhetore që kanë akses në SIFQ dhe arkivën elektronik (AE); (28) Zërat e detajuara të hyrjeve dhe daljeve në Parashikimin e Flukseve të Likuiditetit të përfshira; (29) Përqindja e kontabilistëve të qeverisë që kanë përfunduar trajnimin SNKSP; (30) Plani Vjetor i Huamarrjes dhe Raporti i Monitorimit i SMB-së i përgatitur dhe publikuar; (31) Rritja e numrit të instrumenteve për menaxhimin aktiv të likuiditetit; (32) Përqindja e Institucioneve Publike që përmbushin kërkesat e MFK-së; (33) Përqindja e institucioneve publike që kanë të vendosur mekanizma adekuat të llogaridhënies menaxheriale; (34) Ligji dhe aktet nënligjore të MFK-së janë ndryshuar dhe miratuar; (35) Përqindja e institucioneve publike që kanë adoptuar të gjitha mjetet e menaxhimit të riskut; (36) Numri i institucioneve publike që mbulohen nga auditimet e brendshme vjetore; (37) Numri i institucioneve publike që kanë një komitet funksional auditimi; (38) Përqindja e njësive të auditimit të brendshëm që kanë krijuar dhe zbatuar PPSC në përputhje me standardet në fuqi; (39) Përqindja e audituesve të brendshëm që përputhen me kërkesat e ZHVP; (40) Hartohet dhe miratohet paketa për marrjen e besimit IPA-III; (41) Metodologjia e auditimit të PPP-ve dhe koncesioneve e institucionalizuar.

2.2 Ndikimi i zbatimit të strategjisë së MFP-së në përputhje me axhendën e Integrimit Evropian

Reforma e menaxhimit të financave publike vazhdon të jetë një prioritet i Qeverisë Shqiptare, jo vetëm si një nga parakushtet për anëtarësimin në BE në kuadër të Reformës së Administratës Publike (RAP), por synon edhe mbështetjen një ekonomie më të zhvilluar me shërbime më të mira për qytetarët. Progresi i kënaqshëm në zbatimin e reformave për përmirësimin e menaxhimit të financave publike, duke përfshirë mobilizimin e të ardhurave të brendshme, si dhe relevanca dhe besueshmëria në vazhdimësinë e programit të reformës është një nga kushtet e përgjithshme për disbursimin e kësteve të mbështetjes buxhetore nën fondet IPA, si dhe për Agjendën e Reformave. Në këtë kuadër, Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 adreson


disa sfida me të cilat po përballlet Shqipëria në rrugën e saj drejt BE-së. Për më tepër, progresi i MFP-së është pjesë e disa raporteve të monitorimit dhe vlerësimit, siç janë: Raporti i Grupit të Posaçëm të Reformës së Administratës Publike (GP RAP), Udhërrëfyesi RAP, Raporti i monitorimit SIGMA, Vlerësimi i PEFA-s dhe Raporti i Progresit të BE-së për Shqipërinë.

Në lidhje me **GP RAP BE-Shqipëri**, ai shërben si platforma kryesore për të shtyrë përpara punën për RAP-in. Raporte periodike mbi ndjekjen e konkluzioneve të GP RAP përgatiten nga Qeveria Shqiptare dhe në çdo mbledhje vjetore nxirren konkluzione mbi fushat që duhen përmirësuar. Takimi i 12-të i GP RAP u mbajt në qershor 2024, në të cilin u lanë disa konkluzione operacionale, si: (1) Shqipëria të nisë zbatimin e Strategjisë së MFP-së të miratuar së fundmi; (2) Shqipëria të vazhdojë reformat për të parandaluar krijimin e detyrimeve të prapambetura, me fokus të veçantë tek detyrimet e prapambetura në nivelin e qeverisjes vendore dhe detyrimet e prapambetura që lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore (nga çështjet civile, ashtu edhe administrative); (3) Shqipëria të thjeshtojë proceset e vendimmarrjes dhe menaxhimit për investimet publike, pavarësisht burimit të financimit, nëpërmjet aplikimit të VKM-së për këtë çështje. Shqipëria të sigurojë burime të mjaftueshme në MF për rolin e mbikëqyrjes financiare. Shqipëria të përmirësojë më tej raportimin mbi investimet, përfshirë PPP-të, duke zgjeruar mbulimin dhe cilësinë e raporteve të monitorimit; (4) Shqipëria të forcojë më tej raportimin mbi performancën financiare të NSH-ve, duke përfshirë vlerësimin e riskut fiskal; (5) Shqipëria të kufizojë përdorimin e akteve normative për rishikimin e buxhetit dhe të rikthehet tek procedura standarde e rishikimit të buxhetit, duke respektuar plotësisht rolin mbikëqyrës të Parlamentit. Këto konkluzione do të monitorohen dhe do të ndiqen nga MF, dhe progresi i tyre do të raportohet në takimin e ardhshëm të GP RAP.

Në lidhje me Udhërrëfyesin e RAP, pas takimit dypalësh ndërmjet Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Shqipërisë për Reformën e Administratës Publike (Grup Kapitulli 1), të mbajtur më 12 dhjetor 2022, Departamenti i Administratës Publike, si institucioni udhëheqës në këtë fushë, inicioi procesin për përgatitjen e Udhërrëfyesit të RAP për 6 fusha tematike nën RAP, ku “Menaxhimi i Financave Publike” është një nga fushat tematike. Udhërrëfyesi i RAP u miratua me VKM nr. 737, datë 13.12.2023. Gjatë vitit 2024, MF ka vazhduar të monitorojë zbatimin e masave dhe të raportojë progresin në baza tremujore.

Në lidhje me raportin e monitorimit SIGMA 2024, procesi i vlerësimit SIGMA për Shqipërinë filloi në janar 2024. Parimet e Administratës Publike janë të organizuara në 6 fusha tematike, 32 parime dhe 289 nëntregues. Ministria e Financave është përgjegjëse për fushën tematike “Menaxhimi i Financave Publike”, si dhe kontribuon në 5 fushat e tjera tematike. Fusha tematike “Menaxhimi i Financave Publike” përbëhet nga 10 parime, ku 6 prej tyre lidhen drejtpërdrejt me funksionet e Ministrisë së Financave. Ministria e Financave ka bashkëpunuar gjithashtu me institucione të tjera për futjen e të dhënave në sistem, si: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministrinë e Brendshme; Ministrinë e Arsimit dhe Sportit; Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar. Gjatë periudhës shkurt – mars 2024, të dhënat u mblodhën dhe u ngarkuan në sistemin online PAR.IS dhe në prill 2024 u zhvilluan takime të dedikuara me njësitë përgjegjëse. Draft raporti i përgatitur nga ekspertët u shpërnda për verifikim të të dhënave dhe fakteve nga Qeveria Shqiptare në shtator 2024, një proces që zgjati deri në tetor 2024. Raporti i monitorimit SIGMA 2024 u finalizua dhe u publikua². Sipas raportit, Shqipëria mbetet lider rajonal në funksionimin e administratës publike në disa fusha tematike, veçanërisht në menaxhimin e financave publike (MFP). Krahësimi për fushën tematike MFP ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor paraqitet në grafikun më poshtë.

² https://www.oecd.org/en/publications/public-administration-in-albania-2024_5577d117-en.html

Grafiku 4. Vlerësimi SIGMA 2024 krahasimi ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor

Burimi: SIGMA / OECD 2025

Performanca e Shqipërisë sipas treguesve tregon një kombinim të pikave të forta dhe fushave për përmirësim kur krahasohet me vendet fqinje të Ballkanit. Ajo shënon veçanërisht rezultat të lartë në Treguesin 28.1, duke arritur një vlerë të konsiderueshme prej 91, që reflekton performancë të fortë në cilësinë e kuadrit ligjor për prokurimet publike. Në përgjithësi, Shqipëria paraqet sukses të kënaqshëm të treguesve, me hapësirë për përmirësim në disa fusha krahasuar me vendet e rajonit.

Në maj 2024 filloi Vlerësimi PEFA 2024 për Shqipërinë. Vlerësimi mbuloi të dhënat për vitet fiskale 2021, 2022 dhe 2023. Vlerësimi PEFA 2024 synon t'i japë Qeverisë së Shqipërisë një diagnozë objektive të përditësuar të performancës së Menaxhimit të Financave Publike në nivel qendror bazuar në metodologjinë PEFA, mbështetur në 31 tregues të performancës. Në vijim janë fushat e MFP-së që do t'i nënshtrohen këtij vlerësimi: (i) planifikimi dhe zbatimi i buxhetit; (ii) marrëdhëniet fiskale ndërqeveritare; (iii) informacioni mbi performancën për ofrimin e shërbimeve; (iv) akses publik në informacionin fiskal; (v) menaxhimi i investimeve publike; (vi) monitorimi i aseteve publike; (vii) parashikimet makroekonomike; (viii) menaxhimi i borxhit; (ix) administrimi i të ardhurave; (x) parashikueshmëria e alokimit të burimeve brenda vitit; (xi) shpenzimet për detyrimet e prapambetura; (xii) kontrollet e listës së pagave dhe kontrollet e brendshme mbi shpenzimet jopaga; (xiii) sistemi i prokurimit; auditimi i brendshëm dhe i jashtëm; integriteti i të dhënave financiare. Ky proces u menaxhua dhe u mbikëqyr nga Qeveria e Shqipërisë, Delegacioni i BE-së, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, SECO dhe SIDA. Ministria e Financave luajti rolin e koordinatorit dhe mbështetësit për ekipin e konsulentëve të pavarur të kontraktuar nga Delegacioni i BE-së. Draft raporti i vlerësimi u finalizua në dhjetor 2024. Vlerësimi i PEFA 2024 u krye duke përdorur të njëjtën metodologji si vlerësimi PEFA 2016. Si rrjedhojë, ndryshimet në performancë janë plotësisht të krahasueshme dhe tregojnë se shumica (58%) e fushave të MFP-së nuk kanë pësuar ndryshim, dhe pothuajse një e treta (29%) kanë arritur rezultate më të larta në vitin 2024. Proceset dhe funksionet që kanë shënuar rënie përbëjnë 13%.

Përsa i përket **raportit të BE-së për 2024 për Shqipërinë**³, gjetjet kryesore janë paraqitur në kutinë e mëposhtme.

- **Menaxhimi i financave publike (MFP) është kryesisht i konsoliduar, por ka nevojë për përmirësim.** Baza ligjore për MFP-në është në pjesën më të madhe e konsoliduar, me një ligj organik të buxhetit gjithëpërfshirës. Strategjia e re e MFP-së 2023-2030 u miratua në qershor 2024 dhe mbulon në mënyrë retrospektive vitin 2023. Ajo është gjithëpërfshirëse, duke përfshirë të

³https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8ecc3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

gjitha aspektet e MFP-së dhe mobilizimin e të ardhurave të brendshme, dhe fokusohet kryesisht në veprimet afatmesme për periudhën 2023-2026.

- **Dispozitat e ligjit organik të buxhetit ndiqen kryesisht.** Megjithatë, rishikimet e buxhetit vazhdojnë të kryhen pothuajse ekskluzivisht përmes akteve normative nga ekzekutivi, një instrument i cili është më i përshtatshëm për raste urgjence.
- **Sistemet mbështetëse për ndjekjen e zbatimit të buxhetit janë zhvilluar më tej dhe janë vënë në zbatim.** Niveli i detyrimeve të prapambetura është reduktuar, por përpjekjet e vazhdueshme për forcimin e respektimit të angazhimeve duhet të vijojnë.
- **Janë ndërmarrë veprime për forcimin e monitorimit të riskut fiskal.** Megjithatë, raportimi dhe vlerësimi i riskut fiskal, veçanërisht për risqet që lidhen me ndërmarrjet shtetërore dhe partneritetet publike-private, duhet të përmirësohen më tej.
- **Transparenca buxhetore** është kryesisht e kënaqshme me publikimin e të gjitha dokumenteve kyçe buxhetore.

Për më tepër, bazuar në të dhënat e raportuara nga njësitë përgjegjëse të MFP-së, rezulton se 14 nga 24 komponentët e reformës së MFP-së lidhen me kapitujt e SKZHIE-së, përfshirë grupimet themelore.

2.3 Ndikimi i zhvillimit të sektorit në rajon dhe/ose më gjerë

Ky seksion ofron një vështrim krahasues të treguesve kryesorë makroekonomikë midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, me fokus në financat publike dhe performancën ekonomike. Supozohet se vendet e Ballkanit Perëndimor ndjekin kryesisht një axhendë të ngjashme të reformës së MFP-së, e lidhur me qëllimin e përgjithshëm të anëtarësimit në BE. Bazuar në të dhënat e paraqitura në Raportin e Rregullt Ekonomik të Ballkanit Perëndimor dhe siç paraqitet në tabelën e mëposhtme, krahasuar me vendet e tjera shfaqet një tablo e përzier e performancës së Shqipërisë. Përgjatë viteve ka një ulje të rritjes reale të PBB-së, nga 9% në vitin 2021 në 4 % në vitin 2024. Kosova dhe Serbia kanë nivelet më të larta në rajon. Të ardhurat si përqindje e PBB-së janë më të ulëtat në rajon, ndërsa balanca primare luhetet dhe është 1.4 në vitin 2024. Borxhi si përqindje e PBB-së është ulur vitet e fundit, por mbetet në nivelin 54.2% në vitin 2024, nivel më i ulët se në Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, por më i lartë se shtetet e tjera në rajon. Shqipëria ka performuar më mirë se mesatarja e rajonit përsa i përket normës mesatare të rritjes gjatë këtyre viteve, duke reflektuar gjithashtu një recesion më të lehtë gjatë pandemisë në vitin 2020 dhe një rimëkëmbje të fortë më pas, krahasuar me mesataren e shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Tabela 1. Treguesit fiskalë në shtetet e Ballkanit Perëndimor 2021 - 2024

Treguesit makro	Rritja reale e PBB-së (%)			Të ardhura (% e PBB)			Balanca Primare (% e PBB)			Borxhi (% e PBB)		
	2021	2022	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023
Shqipëria	9.0	4.8	4.0	27.4	26.6	27.2	-2.7	-1.8	0.7	74.1	64.1	57.6
Bosnja dhe Hercegovina	7.4	4.2	1.7	41	40.2	41.3	0.3	1.1	-0.1	37.6	31.5	28.5
Kosova	10.7	4.3	3.3	27.4	27.9	29.4	-0.9	-0.1	0.2	21.6	20	17.5
Mali i Zi	13.0	6.4	6.3	44.0	38.6	42.2	0.2	-3.3	2.4	86.8	70.9	60.8
Maqedonia e Veriut	4.5	2.2	1.0	32.1	32.1	34.9	-4.1	-3.4	-3.1	60.3	59.0	62.0
Serbia	7.7	2.5	2.5	43.2	43.4	42.6	-2.4	-1.5	-0.4	57.1	55.6	52.6

Treguesit makro	Rritja reale e PBB-së (%) 2024 p	Të ardhura (% e PBB) 2024 p	Balanca primare (% e PBB) 2024 p	Borxhi (% e PBB) 2024 p ⁴
Shqipëria	4.0 ⁵ *	28.2*	1.4*	54.2*
Bosnja dhe Hercegovina	2.8	42.2	-0.8	28.2
Kosova	3.8	29.2	-0.7	17.4
Mali i Zi	3.4	41.5	-0.8	63.6
Maqedonia e Veriut	1.8	37.3	-2.9	63.5
Serbia	3.8	43.3	0.2	37


Burimi: Grupi i Bankës Botërore⁶

*Burimi: Vlera Faktike për vitin 2024 nga INSTAT & MF

2.4 Aktivitetet e shtyllave që nuk përparuan sipas planit

Bazuar në vetë-vlerësimin, progresi i MFP-së ka qenë i kënaqshëm, me 77.69% të progresit në nivel aktiviteti (kjo përfshin “26.92% të përfunduar” dhe “50.77% në rrugën e duhur”). Grafiku më poshtë paraqet një vështrim të statusit të aktiviteteve për të gjashta shtyllat.

Grafiku 5. Niveli i përgjithshëm i aktiviteteve të strategjisë së MFP




Ndërkohë, ka disa aktivitete që nuk kanë ecur sipas planit. Në total, 9.23% e aktiviteteve janë pjesërisht në rrugën e duhur, 11.54% e aktiviteteve nuk kanë filluar gjatë vitit 2024 dhe për 1.54% të tyre nuk kishte të dhëna të disponueshme në momentin e raportimit. Puna do të vazhdojë në vitin e ardhshëm për këto aktivitete.

Grafiku 6. Aktivitetet që nuk kanë përparuar sipas planit gjatë 2024

⁴ Vlera të Parashikuara për vitin 2024

⁵ <https://www.instat.gov.al/en/themes/economy-and-finance/national-accounts-gdp/#tab2> Të dhënat për Shqipërinë për vitin 2024 janë më të fundit të ofruara nga autoritetet kombëtare, si INSTAT dhe Ministria e Financave.

⁶Raport i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor Nr.26 | Vjeshtë 2024. <https://documents1.worldbank.org/curated/en/099101424043012347/pdf/P5067421db658a06b1a82c1811f0301d818.pdf>



2.5 Zbatimi i buxhetit të përgjithshëm

Shumica e reformave të përfshira në këtë strategji janë reforma politikash. Puna për formalizimin e këtyre reformave në trajtën e legjislacionit dhe rregulloreve të reja dhe/ose të modifikuara në përgjithësi nuk kërkon burime financiare shtesë. Staf i ekzistues i institucioneve të përfshira në zbatimin e reformave ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të arritur rezultatet e dëshiruara. Plani i Veprimit 2023-2026 parashikon që kostoja totale shtesë për zbatimin e aktiviteteve është 11.58 milionë euro, nga të cilat 811,152 euro do të mbulohen nga Buxheti i Qeverisë dhe 10.77 milionë euro nga Partnerët për Zhvillim Ndërkombëtar. Ndërsa, buxheti i planifikuar për Planin e Veprimit 2024 ishte 4.342 milionë euro (376,607 euro nga Buxheti i Qeverisë dhe 3,965,948 euro nga Partnerët Ndërkombëtarë për Zhvillim). Gjatë vitit 2024, burimet totale të përdorura për zbatimin e reformës ishin 388,917 euro nga Buxheti i Qeverisë dhe 2,078,833 euro nga Partnerët Ndërkombëtarë për Zhvillim.

3 Progresi në zbatimin e Shtyllave të Strategjisë së MFP-së

Në seksionet më poshtë janë përshkruar detajet specifike të zhvillimeve për secilën shtyllë.

3.1 Progresi në Shtyllën 1 “Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut”

Gjatë vitit 2024, janë ruajtur dhe përmirësuar më tej sistemet për (i) zhvillimin dhe monitorimin e politikave fiskale të shëndosha të bazuar në rregullat fiskale, (ii) parashikimet e avancuara makroekonomike dhe (iii) praktikatat solide të menaxhimit të risqeve fiskale. Të gjitha objektivat e vendosura për vitin 2024 janë arritur ose janë tejkaluar dhe janë të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.


Tabela 2: Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 1

Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2024	Vlera faktike 2024
Objektivi specifik (Komponenti) 1.1 Programim makroekonomik i matur dhe realist				
1	PBB nominale: diferenca e vlerave të parashikuara ndërmjet MF-së dhe FMN-së nuk duhet të jetë më e madhe se zero.	0.0 miliardë Lek (2022)	≤ 0	-44.8

2	Balanca Primare: duke filluar nga viti 2024, Balanca Primare do të mandatohet ligjërisht si rregull i ri fiskal dhe parashikohet të jetë jo më pak se zero.	-1.8 % e PBB (2022)	≥ 0	1.4
Objektivi specifik (Komponenti) 1.2 Krijimi i një Analize gjithëpërfshirëse të Qëndrueshmërisë së Borxhit				
1	Përfundimi i asistencës teknike për Analizën e Qëndrueshmërisë së Borxhit.	- (2022)	Kërkesa për Asistencë Teknike	Asistencë teknike e marrë nga BB
Objektivi Specifik (Komponenti) 1.3 Menaxhimi i Risqeve Fiskale				
1	Prezantimi i Deklaratës vjetore të Riskut Fiskal.	-	E pilotuar	DRF për VF 2023 është finalizuar dhe miratuar nga Ministri i Financave, dhe është dorëzuar zyrtarisht në Këshillin e Ministrave.
Objektivi Specifik (Komponenti) 1.4: Këshilli Fiskal				
1	Krijimi i Këshillit Fiskal	-	Përgatitja e raportit me opsionet mbi Këshillin Fiskal	Raporti teknik i përgatitur nga BB

Progres i kënaqshëm është bërë edhe drejt përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2024. 41.67% e aktiviteteve janë përfunduar, 33.33% janë në rrugën e duhur, 16.67% janë pjesërisht në rrugën e duhur dhe për 8.33% të aktiviteteve nuk ka informacion të disponueshëm.

Grafiku 7: Statusi për vitin 2024 të aktiviteteve në Shtyllën 1



Progresi i Komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2024

Objektivi Specifik 1.1 Programimi Makroekonomik i Matur dhe Realist

Treguesit e Performancës

Objektivat për treguesit e performancës të këtij komponenti janë arritur dhe tregojnë përputhshmëri të plotë me rregullat fiskale për vitin 2024.

Treguesi i parë i performancës për këtë komponent kërkon që diferenca midis parashikimit vjetor të PBB-së nga Ministria e Financave, siç paraqitet në Ligjin Vjetor të Buxhetit që i dorëzohet Kuvendit, dhe parashikimit vjetor të PBB-së nga FMN, siç publikohet në Raportin ‘World Economic Outlook’, të mos jetë më e madhe se zero. Për vitin 2024, kjo diferencë është -44,8 miliardë lekë, siç shpjegohet në tabelën më poshtë.

Tabela 1.2 Parashikimi i PBB nominale

Viti	Parashikimi i MF-së ⁷	Parashikimi në raportin “World Economic Outlook” ⁸	Diferenca
2024	2.494.2 miliardë lekë	2,539.0 miliardë lekë	-44.8 miliardë

Treguesi i dytë i performancës i referohet treguesit makroekonomik ‘balanca primare’, vlera e synuar e së cilës nuk duhet të jetë negative. Ky tregues makroekonomik është përcaktuar me ligj si një Rregull i ri Fiskal duke filluar nga viti 2024 dhe matet si: të ardhurat totale buxhetore minus shpenzimet totale buxhetore plus pagesat e interesit. Ky angazhim është në përputhje me rregullat fiskale të përcaktuara në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB), duke theksuar respektimin e parimeve të shëndosha fiskale për qëndrueshmëri dhe rezistencë afatgjatë ekonomike. Siç përcaktohet në LOB, është e detyrueshme që duke filluar nga viti 2024 dhe për çdo vit pasardhës, balanca primare të mos jetë më e vogël se zero, duke siguruar një pozicion të balancuar ose pozitiv. Më konkretisht, balanca primare arriti nivelin 1.4% për vitin 2024, nga 0.7% në vitin 2023, duke përmbushur kështu rregullin fiskal një vit përpara afatit.

Masat dhe aktivitetet

Parashikimi i kujdesshëm dhe real i treguesve makroekonomikë, krahasimi i vazhdueshëm i projeksioneve (analizë krahasuese) me ato të parashikuesve të pavarur ndërkombëtarë, si dhe përputhshmëria me rregullat fiskale ka përfunduar.

Parashikimet e treguesve makroekonomikë të Ministrisë së Financave janë krahasuar publikisht për vitin 2024. Kjo analizë krahasuese është shpërndarë përmes Kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal (KMF) 2026-2028 dhe Programit të Reformave Ekonomike (PRE) 2025-2027, të miratuara nga Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 46, datë 22.01.2025. Dokumenti i KMF u finalizua dhe u miratua nga Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 83, datë 05.02.2025.

Ruajtja e financave publike të shëndosha dhe kuadrit fiskal të qëndrueshëm përmes respektimit rigoroz të rregullave fiskale të përcaktuara me ligj ka përfunduar. Në vitin 2024, Shqipëria ka respektuar rreptësisht rregullat fiskale të përcaktuara me ligj. Respektimi i rregullave fiskale për vitin 2024 analizohet përmes publikimit të rregullt në një seksion të dedikuar, *Kuadrati Shpjegues: Mbi përputhshmërinë me Rregullat Fiskalë, në dokumentin e KMF, PRE dhe në “Raportin e Zbatimit të Buxhetit Vjetor, Situata Makroekonomike dhe Fiskale”,* siç specifikohet më sipër. Nuk ka vonesa në zbatim.

Rekrutimi i stafit të specializuar, zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve të specializuara për stafin e Drejtorisë së Përgjithshme të Programimit Makroekonomik dhe Fiskal (DPPMF) janë pjesërisht në rrugën e duhur. Vendet vakante nuk janë plotësuar ende. Trajnimi për stafin ekzistues dhe forcimi i kapaciteteve janë në proces, ndërsa rekrutimi për stafin e ri duhet të shpallet publikisht në faqen zyrtare të nëpunësve civilë, e cila operohet nga Departamenti i Administratës Publike (DAP).

⁷https://www.google.com/url?sa=t&source=web&rct=j&opi=89978449&url=https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2025/02/Kuadri-Makroekonomik-dhe-Fiskal-per-periudhen-2026-2028-VKM-Nr-83-date-5.2.2025-1.pdf&ved=2ahUKewjjsPv06JWMAx-WAQ_EDHf5LJRcQFnoECCMQAQ&usq=AOvVaw3yQ2a3fkEoaXzc6Nx9I9CM

⁸ Published at the time the Annual Budget Law was submitted for approval in Parliament (October 2024) and can be accessed in the following link: <https://www.imf.org/en/Publications/SPROLLS/world-economic-outlook-databases#sort=%40imfdate%20descending>

Objektivi Specifik 1.2 Krijimi i një Analize gjithëpërfshirëse të Qëndrueshmërisë së Borxhit

Treguesit e Performancës

Sa i përket treguesit për përfundimin e asistencës teknike për Analizën e Qëndrueshmërisë së Borxhit, Ministria e Financave ka rënë dakord me Bankën Botërore (BB) në fund të vitit 2024 që asistenca teknike dhe raundi i parë i trajnimit për Analizën e Qëndrueshmërisë së Borxhit do të fillojë në vitin 2025.

Masat dhe aktivitetet

Ofrimi i asistencës teknike për procesin e Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit është në rrugën e duhur. Në fund të vitit 2024, Ministria e Financave ka rënë dakord me Bankën Botërore për të nisur trajnimin e stafit për modelin e Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit. Modeli i Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit është vënë në dispozicion të stafit të MF-së dhe aktualisht po plotësohet me të dhëna për Shqipërinë.

Prezantimi i kuadrit të Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit si një instrument për programimin makroekonomik ka përfunduar, në kuadër të asistencës teknike të ofruar nga ekipi i Bankës Botërore, i financuar nga Fondi i Besimit i BE-së, dhe për rrjedhojë mbetemi në rrugën e duhur për të krijuar një sistem të brendshëm të strukturuar për Analizën e Qëndrueshmërisë së Borxhit deri në vitin 2026, siç synohet në treguesin përkatës të strategjisë së MFP-së. Për më tepër, është prezantuar një buletin informues mbi zhvillimet kryesore makroekonomike për investitorët, i cili publikohet çdo tremujor, në faqen zyrtare të MF-së⁹ nga DPPMF dhe Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Shtetëror (DPBSH).

Objektivi Specifik 1.3 Menaxhimi i Risqeve Fiskale

Treguesit e Performancës

Sa i përket treguesit të performancës ‘Prezantimi i Deklaratës vjetore të Riskut Fiskal’, vlera e synuar për vitin 2024 u arrit në vitin 2023. Deklarata e parë pilot e Risqeve Fiskale (DRF) për vitin 2022 u hartua, e cila shërbeu si fazë ushtrimi, duke u fokusuar në koordinimin dhe konsolidimin e informacionit të ofruar nga të gjitha njësitë raportuese, duke hedhur bazat për përmirësimin e menaxhimit të risqeve fiskale në të ardhmen. Gjatë vitit 2024 u finalizua përgatitja e DRF për vitin fiskal 2023. Dokumenti i finalizuar, i miratuar nga Ministri i Financave, është përcjellë zyrtarisht në Këshillin e Ministrave, për qëllime informimi.

Masat dhe aktivitetet

Zhvillimi dhe zbatimi i aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve për menaxhimin e risqeve fiskale janë në rrugën e duhur për vitin 2024. Drejtoria e Risqeve Fiskale u krijua zyrtarisht brenda strukturës së re organizative të Ministrisë së Financave në fillim të vitit 2024. Gjatë gjithë vitit 2024, Njësia e Riskut Buxhetor në Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit, e cila vazhdon të jetë pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave, ka vazhduar të menaxhojë të gjitha detyrat e lidhura me menaxhimin e riskut fiskal. Deri në fund të vitit 2024 dhe fillimin e vitit 2025, Drejtoria e Risqeve Fiskale është plotësuar pothuajse tërësisht me 4 specialistë, nuk është plotësuar vetëm pozicioni i Drejtorit.

Zhvillimi, pilotimi dhe publikimi i Deklaratës Vjetore të Riskut Fiskal çdo vit ka përfunduar për vitin 2024. Gjatë vitit 2024 u finalizua përgatitja e DRF për vitin fiskal 2023. Deklarata u miratua nga Ministri i Financave dhe është dorëzuar zyrtarisht në Këshillin e Ministrave për qëllime informimi. Zgjerimi i fushës së risqeve fiskale të raportuara në DRF për të përfshirë edhe risqe të lidhura me fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike ka qenë **në rrugën e duhur** për vitin 2024. Risqet nga fatkeqësitë natyrore janë integruar tashmë në DRF-në e finalizuar për vitin 2023. Asistenca teknike e ardhshme nga partnerët ndërkombëtarë do të përmirësojë më tej analizën e riskut nga fatkeqësitë natyrore, veçanërisht ato të kryera nga Agjencia e Mbrotjes Civile, me synimin për ta zgjeruar më tej drejt analizës së riskut nga ndryshimet klimatike. Informacioni për konsolidimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të metodologjisë për monitorimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura nuk është i disponueshëm.

Objektivi Specifik 1.4 Këshilli Fiskal

⁹ <https://financa.gov.al/buletini-makroekonomik-2/>

Treguesit e Performancës

Në përputhje me planin, një raport me opsione për krijimin e një Këshilli Fiskal u përgatit nga Banka Botërore, pas diskutimeve të frytshme midis Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore.

Masat dhe aktivitetet

Një raport me opsione që trajton alternativat dhe mënyrat e mundshme për zhvillimin e një Këshilli Fiskal të përshtatur për Shqipërinë është përgatitur nga Banka Botërore. Një plan i detajuar me kosto për Këshillin Fiskal nuk është hartuar ende, pasi opsioni i preferuar nuk është artikuluar zyrtarisht nga MF.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Nuk ka pasur sfida kryesore gjatë vitit 2024, përveç adresimit të vendeve vakante për stafin e specializuar dhe zhvillimit dhe zbatimit të trajnimeve të specializuara për stafin e DPPMF. Trajnimi për stafin ekzistues dhe forcimi i kapaciteteve mbeten procese në vijim, ndërsa rekrutimi për stafin e ri duhet të shpallet publikisht në faqen zyrtare të nëpunësve civilë, e cila operohet nga Departamenti i Administratës Publike (DAP), i cili do të adresohet gjatë vitit 2025.

3.2 Progresi në Shtyllën 2 “Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent”

Gjatë vitit 2024 është punuar për të përmirësuar më tej praktikatat e planifikimit buxhetor dhe të monitorimit të zbatimit të buxhetit. 73.7% e objektivave të TP-ve janë arritur gjatë vitit 2024, 5.3% janë arritur pjesërisht dhe 21% nuk janë arritur. Në përgjithësi, analiza tregon progres pozitiv në shumicën e fushave. Tabela më poshtë paraqet statusin e arritjes së treguesve të performancës të Shtyllës 2 “Planifikimi i integruar strategjik dhe buxhetor, monitorimi dhe raportimi transparent”.

Tabela 3: Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 2

Treguesi		Vlera Bazë (viti)	Vlera e synuar 2024	Vlera faktike 2024
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.1 Planifikimi Strategjik i Integruar				
1	Përqindja e strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara në përputhje me udhëzimet e SPI-së	65% (2022)	75%	75%
2	Përqindja e strategjive dhe planeve të veprimit të monitoruara përmes SIPI	NA	30%	0%
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.2: Planifikimi Buxhetor Afatmesëm				
1	Treguesi PEFA 16 Perspektiva Afatmesme në buxhetimin e shpenzimeve	C+	B	C+
2	Treguesi SIGMA 6.7.1 Funksionimi i kontrollit të brendshëm (Lidhja ndërmjet strukturave menaxheriale dhe buxhetore) (%)	0/3 (2021)	Trend rritës	2/2 ¹⁰
6	Prezantimi i rishikimeve të shpenzimeve.	-	Metodologjia e përgjithshme e	Metodologjia e përgjithshme nuk është përgatitur dhe rregulluar.

¹⁰ Në Vlerësimin SIGMA 2024, treguesi që vlerëson përputhshmërinë midis strukturave të menaxhimit dhe buxhetit pësoi një ndryshim të rëndësishëm. Më parë konsiderohej si nën-tregues brenda Treguesit 6.7.1 – ‘Funksionimi i kontrollit të brendshëm’ dhe vlerësohej me 3 pikë; tani është riklasifikuar si kriter brenda nën-treguesit ‘Përgjegjësia menaxheriale’, me një maksimum prej 2 pikësh sipas metodologjisë së re. Sipas raportit të monitorimit SIGMA 2024, ky kriter ka marrë vlerësimin e plotë 2/2, duke treguar një përputhje të fortë midis strukturave të menaxhimit dhe buxhetit, me ekzekutimin e buxhetit të realizuar përmes njërive shpenzuese të përcaktuara qartë. Raporti SIGMA mund të aksesohet në linkun vijues: <https://www.sigmaweb.org/publications/monitoring-reports.htm>

			përgatitur dhe rregulluar ¹¹	
7	Prezantimi i analizës së hendeut gjinor si pjesë e BPGJ-së	-	Metodologjia e analizës së hendeut gjinor e përgatitur dhe e rregulluar ¹²	Metodologjia e analizës së hendeut gjinor e përgatitur dhe e rregulluar
8	Prezantimi i buxhetimit të gjelbërt të përgjigjshëm ndaj ndryshimeve klimatike	-	Metodologjia për Buxhetimin e Përgjigjshëm ndaj ndryshimeve klimatike është përgatitur dhe rregulluar ¹³	Metodologjia për Buxhetimin e Përgjigjshëm ndaj ndryshimeve klimatike është përgatitur dhe rregulluar
9	Miratimi i DPP-së së bashku me Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare	(2022)	Bashkëpunimi me Ministrinë e Linjës dhe miratimi me VKM çdo fillim viti	"100% Bashkëpunimi me Ministrinë e Linjës dhe miratimi me VKM çdo fillim viti "
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.3: Menaxhimi i Investimeve Publike				
2	Prezantimi i procedurave të përmirësuara të MIP-së (përfshirë mekanizmat përkatës të vendimmarrjes)	-	Përmirësimi dhe zbatimi i procedurave të MIP-së	Procedurat e MIP-së të përmirësuara dhe të zbatuara
3	Pjesa e projekteve të investimeve publike që propozohen në bazë të prioriteteve strategjike të qeverisë (vlera e projekteve në një vit të caktuar)	82% (2020)	≥ 82%	93%
4	Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime.	98% (2022)	≥ 98%	98.4%
5	Raporti i investimeve të reja publike të paraqitura brenda ciklit të PBA-së kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit.	74.2% (2022)	≥ 80%	81.3%
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.4: Financat Vendore				
1	Formula e grantit e rregulluar bazuar në të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë	n/a	Formula e grantit e rregulluar	Formula e rregulluar
2	Prezantohet skema shtesë e granteve të bazuara në performancë (SGBP).	n/a	SGBP i hartuar	SGBP i përcaktuar
4	Përqindja e bashkive që përdorin software-in e ri SMBV	-	30%	80%
7	Prezantimi nga MF i Software-it të Menaxhimit të Buxhetit Vendor dhe E-Platformës	-	E-platforma plotësisht funksionale dhe e përdorur	E-platforma plotësisht funksionale dhe e përdorur
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.5: Raportimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Buxhetit				
1	Treguesi i Performancës PEFA 28 "Raportet e buxhetit gjatë vitit"	D+ (2017)	B	D+
2	Publikimi i raporteve të zbatimit të buxhetit për qytetarët	-	Miratimi i formateve	Finalizuar
4	Numri i kontratave PPP të mbuluara në raportin vjetor të përmbledhur për PPP-të dhe kontratat koncesionare.	-	100	Plus 100


¹¹ Rishikuar dhe miratuar në Mbledhjen e 18-të të Komitetit Drejtues të MFP-së, të mbajtur më 31 tetor 2024.

¹² Rishikuar dhe miratuar në Mbledhjen e 18-të të Komitetit Drejtues të MFP-së, të mbajtur më 31 tetor 2024.

¹³ Rishikuar dhe miratuar në Mbledhjen e 18-të të Komitetit Drejtues të MFP-së, të mbajtur më 31 tetor 2024.

Progres i kënaqshëm është bërë edhe drejt përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2024. 27.78% janë përfunduar, 52.78% janë në rrugën e duhur, 13.89% janë pjesërisht në rrugën e duhur dhe 5.56% nuk kanë filluar ende.

Grafiku 8: Statusi për vitin 2024 të aktiviteteve në shtyllën 2



Progresi i Komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2024

Objektivi Specifik 2.1 Planifikimi Strategjik i Integruar

Treguesit e Performancës

Përqindja e strategjive dhe planeve të veprimit të hartuara në përputhje me udhëzimet e SPI është rritur nga 70% në vitin 2023 në 75% në vitin 2024.

Arritja prej 75% në koordinimin e politikave dhe prioriteteve vjen nga përpjekjet kyçe strategjike dhe bashkëpunuese. Janë miratuar disa strategji kombëtare të rëndësishme, si Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP) 2025-2027, duke theksuar planifikimin efektiv strategjik. Këto strategji krijojnë një bazë të fortë për arritjen e qëllimeve më të gjera të politikave. Bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe proceset e rishikimit, të tilla si partneriteti i SASPAC me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe projektin BE për Qeverisjen e Mirë, pasqyrojnë angazhimin për optimizimin e sistemeve të qeverisjes si SIPI/IPSIS dhe SIMAJ. Këto përpjekje ilustrojnë një qasje dinamike ndaj zbatimit dhe përmirësimit të politikave. Takimet e rregullta të organizuara nga GMIP “Për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor” dhe grupet tematike sigurojnë angazhim të vazhdueshëm të palëve të interesuara, duke rritur reagueshmërinë dhe përshtatshmërinë e politikave. Ndryshimi i Urdhrit Nr. 90 për përditësimin e përgjegjësisë ministrore dhe menaxhimin e GMIP-ve mbështet më tej përmirësimet në qeverisje. Së fundi, integrimi i strategjive ndërsektoriale si Strategjia Kundër Korrupsionit dhe Strategjia e Drejtësisë demonstroi një përpjekje gjithëpërfshirëse për të harmonizuar fusha të ndryshme politike. Kjo qasje gjithëpërfshirëse është thelbësore për përparimin drejt objektivave të përcaktuara, duke dëshmuar arritjen prej 75%, me punë të vazhdueshme të nevojshme për realizimin e plotë të objektivave strategjike.

Sa i përket përqindjes së strategjive dhe planeve të veprimit të monitoruara përmes SIPI/IPSIS, vlera e synuar nuk është arritur.

Masat dhe aktivitetet

Të gjitha aktivitetet me qëllim përmirësimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar të mbështetur nga TI, për formulimin dhe monitorimin e strategjive, kanë vijuar në rrugën e duhur, me përjashtim të përditësimit të SIMAJ, i cili ka qenë pjesërisht në rrugën e duhur.

Koordinimi i politikave dhe prioriteteve është një proces periodik dhe i vazhdueshëm, dhe aktiviteti i GMIP-ve raportohet pranë Komitetit të Planifikimit Strategjik.

Sa i përket përmirësimit të ligjeve, akteve nën ligjore dhe udhëzimeve për planifikimin e integruar, aty ku ka qenë e nevojshme, gjatë vitit 2024 janë miratuar: (i) Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP) 2025-2027 me VKM nr. 161, datë 20.03.2024; (ii) Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025 me VKM nr. 458, datë 09.07.2024; (iii) Strategjia Ndërsektoriale e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2024-2030 me VKM nr. 326, datë 29.05.2024; (iv) Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030 me VKM nr. 152, datë 13.03.2024; (v) Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2024-2030 me VKM nr. 271, datë 02.05.2024; (vi) Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 me VKM nr. 304, datë 21.05.2024; (vii) Strategjia Sektoriale për Menaxhimin e Financave Publike 2023-2030 me VKM nr. 390, datë 12.06.2024; (viii) Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030 me VKM nr. 787, datë 18.12.2024; (ix) Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030. SASPAC po bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit SIPI/IPSIS, ku pjesë e ndryshimeve do të jetë përfshirja e GMIP-ve. Këto ndryshime po rishikohen në bashkëpunim me projektin BE për Qeverisjen e Mirë, i cili mbështet SASPAC në analizën e funksionimit të SIPI/IPSIS. GMIP “Për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor” ka thirrur takime të rregullta gjatë vitit 2024 – duke përfshirë takimet e grupeve tematike. SASPAC po bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Procesi për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e mëtejshëm të SIMAJ dhe strukturës/planit të raportimit të tij është në proces, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përfituese dhe komunitetin e donatorëve.

Zgjerimi i rishikimit afatmesëm dhe vlerësimit ex-post të strategjive dhe planeve të veprimit ka qenë pjesërisht në rrugën e duhur. Gjatë vitit 2024, SASPAC ka punuar me mbështetjen e projektit BE për Qeverisjen e Mirë për ndryshimin e Urdhrit Nr. 90¹⁴, datë 01.08.2023, të Kryeministrit, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, për të reflektuar gjithashtu ndryshimet e bëra në fushat e përgjegjësisë së ministrave dhe menaxhimit të GMIP-ve.

Objekti i Specifik 2.2 Planifikimi Buxhetor Afatmesëm

Treguesit e Performancës

Sa i përket Planifikimit Buxhetor Afatmesëm, për vitin 2024, sipas draft raportit të vlerësimit PEFA, vlera faktike për Treguesin e Performancës 16 – Perspektiva Afatmesme në buxhetimin e shpenzimeve, është vlerësuar C+.

Sipas Raportit të Vlerësimit SIGMA për vitin 2024, lidhja ndërmjet strukturave menaxheriale dhe buxhetore është e fortë, me zbatimin e buxhetit që kryhet përmes njësive shpenzuese të përcaktuara qartë.

Treguesi i performancës i lidhur me prezantimin e rishikimeve të shpenzimeve nuk është arritur, megjithatë, Drejtoria e Buxhetit në Ministrinë e Financave ka nisur punën përgatitore. Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar takime me asistencën teknike dhe është punuar për të studiuar praktikën e ndjekura nga shtete të tjera, me qëllim përshtatjen e metodologjisë për Shqipërinë. Parashikohet që, me mbështetjen e projektit BE për Qeverisjen e Mirë, të përfundojë analiza e praktikave më të mira dhe, mbi këtë bazë, të finalizohet metodologjia për rishikimet e shpenzimeve në vitin 2025.

Metodologjia e Analizës së Hendekut Gjinnor u miratua me Udhëzimin Nr. 12, datë 18.10.2024. Gjatë periudhës shtator-dhjetor 2024, u ndërмор një nismë për rishikimin e Udhëzimit Standard Nr. 7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së”¹⁵. Si pjesë e këtij rishikimi, shtojca e dedikuar për buxhetimin gjinnor u përditësua për të përfshirë elemente shtesë lidhur me hapat për përgatitjen e analizës gjinnore.

¹⁴ Urdhri Nr. 90, datë 01.08.2023, i Kryeministrit, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe për ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”

¹⁵ Udhëzimi Standard Nr. 7, datë 28.02.2018, ‘Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA)’.

Metodologjia për Buxhetimin e Përgjigjshëm ndaj Ndryshimeve Klimatike u miratua me Udhëzimin Nr. 12/2024¹⁶. Gjatë periudhës shtator- dhjetor 2024, u ndërmor një nismë për rishikimin e Udhëzimit Standard Nr. 7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së”¹⁷. Si pjesë e këtij rishikimi, u shtua një shtojcë e veçantë, e cila përcakton konceptin dhe përshkruan hapat që ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore duhet të ndjekin për identifikimin dhe alokimin e fondeve buxhetore për politikën e lidhura me ndryshimet klimatike. Gjithashtu, u përcaktuan qartë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e përgatitjes së PBA-së, veçanërisht në lidhje me ndryshimet klimatike.

Hartimi dhe miratimi i Dokumentit të Politikave Prioritare së bashku me Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP) në muajin janar të çdo viti është përfunduar plotësisht. Ky integrim u formalizua me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 161, datë 20.03.2024. Ky zhvillim përfaqëson një qasje të koordinuar ndaj mbrojtjes sociale, duke harmonizuar prioritetet kombëtare me nismat e planifikimit strategjik. Duke integruar NSPP-në në Dokumentin e Politikave Prioritare 2025-2027, qeveria demonstroi angazhimin e saj për përmirësimin e mirëqenies dhe kohezionit social, duke hapur rrugën për veprime të ardhshme të fokusuara në zhvillimin socio-ekonomik dhe zbatimin efektiv të politikave. Për vitin 2025 parashikohen veprime të mëtejshme për rritjen e frekuencës së përditësimit të NSPP-së dhe forcimin e përmbajtjes së saj.

Masat dhe Aktivitetet

Janë ndërmarrë disa hapa të mëtejshme për forcimin e llogaridhënies menaxheriale për formulimin e PBA-së. Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar takime me ekipet e asistencës teknike për të diskutuar çështje që lidhen me llogaridhënien menaxheriale në procesin e përgatitjes së PBA-së, duke përfshirë ndryshimet e mundshme në legjislacionin përkatës dhe sistemin SIMFSH (Sistemi Informativ të Menaxhimit Financiar Shqiptar). Për të forcuar më tej procesin janë planifikuar disa ndryshime në SIMFSH. Megjithatë, aktiviteti i lidhur me zbatimin e kuadrit të përditësuar të llogaridhënies menaxheriale përmes projekteve pilot, fushatave ndërgjegjëse dhe aktiviteteve trajnuese nuk ka nisur ende. Ky proces do të zhvillohet pasi të miratohet legjislacioni i rishikuar.

Aktivitetet që synojnë përmirësimin e procedurave dhe përditësimin e kuadrit rregullator për dëgjesat e brendshme buxhetore midis Ministrisë së Financave dhe Institucioneve Buxhetore, si dhe për pjesëmarrjen publike në procesin e përgatitjes së PBA-së, janë përfunduar. Për më tepër, procesi i zhvillimit të dëgjesave buxhetore është përmirësuar përmes mbajtjes së minutave të takimit dhe regjistrimeve të takimeve. Ky përmirësim ndjek rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të procedurave dhe cilësisë së organizimit të dëgjesave buxhetore. Në tetor 2024, Udhëzimi Nr. 7/2018 u rishikua për të forcuar procesin e organizimit të dëgjesave publike për buxhetin, duke përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira.

Drejtorja e Analizës dhe Programimit Buxhetor ka nisur hartimin e një akti rregullator për publikimin e devijimeve midis taveve në çdo fazë të procesit buxhetor. Ky akt parashikohet të jetë një rregullore e re e miratuar nga Ministri i Financave dhe do të sigurojë raportim transparent të diferencave midis taveve të PBA-së dhe taveve buxhetore (siç miratohen nga parlamenti). Ky aktivitet pritet të përfundojë në vitin 2025. **Për të përmirësuar dokumentacionin buxhetor dhe në veçanti cilësinë e informacionit mbi performancën, deri në fund të vitit 2024 u zhvilluan disa trajnime.** Këto trajnime, të mbështetura nga partnerët, synuan rritjen e kapaciteteve të pjesëmarrësve në përgatitjen e PBA-së, me fokus në identifikimin e Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP) të lidhur me ndryshimeve klimatike dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor (BPGJ).

Aktiviteti i lidhur me prezantimin e rishikimeve të shpenzimeve ka qenë pjesërisht në rrugën e duhur. Janë zhvilluar takime me asistencën teknike për të diskutuar metodologjinë. Aktualisht po analizohen përvojat

¹⁶ Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 12, datë 18.10.2024, mbi metodologjinë e buxhetimit të përgjigjshëm ndaj ndryshimeve klimatike.

¹⁷ Udhëzimi Standard Nr. 7, datë 28.02.2018, ‘Për procedurat standarde për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA)’.

e shteteve të tjera që kanë zbatuar këtë metodologji, me qëllim përdorimin e tyre si shembull në hartimin e metodologjisë për Shqipërinë.

Aktiviteti i lidhur me zhvillimin dhe prezantimin e mëtejshëm të BPGJ dhe buxhetimit të përgjigjshëm ndryshim ndaj klimës ka përfunduar. Metodologjia për buxhetimin e gjelbër / të përgjigjshëm ndaj ndryshimeve klimatike u miratua me Udhëzimin nr. 7/2018, i rishikuar me Udhëzimin nr. 12, datë 18.10.2024. NSPP është miratuar si pjesë integrale e Dokumentit të Politikave Prioritare me VKM nr. 161, datë 20.03.2024 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2025-2027”.

Objekti i Specifik 2.3 Menaxhimi i Investimeve Publike

Treguesit e Performancës

Me miratimin e VKM nr. 887, datë 27.12.2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, i ndryshuar: Në gusht 2024, duke iu referuar dispozitave të VKM nr. 887 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, u miratua VKM nr. 533, datë 12.08.2024, ku u miratua Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP). Dejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike (DMIP) ka ndjekur me përpikëri procedurat e VKM-së për fazën e parë dhe të dytë të përgatitjes së PBA-së 2025-2027 dhe ligjit të buxhetit për vitin 2025. Aktualisht, detajimi i projekteve të reja të investimeve publike kryhet sipas procedurave të reja.

Sa i përket pjesës së projekteve të investimeve publike që propozohet në bazë të prioriteteve strategjike të qeverisë (vlera e projekteve në një vit të caktuar), vlera faktike për vitin 2024 është 93%. Ky tregues matet si raporti midis shumës totale të investimeve publike që pasqyrojnë prioritetet strategjike dhe shumës totale të projekteve të investimeve.

Sa i përket disbursimeve aktuale për projektet e mëdha të investimeve krahasuar me disbursimet e planifikuara, shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime, vlera faktike për vitin 2024 është 98.4%. Ky tregues matet si raporti ndërmjet totalit të disbursuar vjetor për projektet e investimeve dhe buxhetit total vjetor të planifikuar për projektet përkatëse.

Sa i përket raportit të investimeve të reja publike të paraqitura brenda ciklit të PBA-së kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit, vlera faktike për vitin 2024 është 81.3%.

Masat dhe aktivitetet

Operacionalizimi i procedurave për përmirësimin e menaxhimit të investimeve publike ka qenë në rrugën e duhur. Moduli MIP në SIMFSH do të ndryshohet, mbikëqyrja e punës në sistemin SIMFSH. Është ngritur një grup pune¹⁸ dhe është kryer një rishikim i parë për zhvillimin e mëtejshëm të modulit MIP në SIMFSH. Objekti është që SIMFSH të mbështesë të gjithë procesin, nga dorëzimi i propozimeve për projektet kapitale deri te monitorimi i zbatimit të projekteve kapitale, duke përfshirë gjenerimin e raporteve për qëllimet e NSPP-së, PBA-së, buxhetit vjetor dhe zbatimit të buxhetit.

Procedurat përkatëse për Menaxhimin e Investimeve Publike, siç përcaktohen në VKM nr. 887/2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, u respektuan plotësisht dhe u bënë ndryshime në procedurat e menaxhimit të investimeve publike me qëllim forcimin e NSPP dhe rritjen e rolit “gatekeeper” të MF-së. Këto ndryshime synojnë të vendosin rregulla të qarta lidhur me maturimin e projekteve dhe zhvillimin dhe vlerësimin e studimeve të fizibilitetit të projekteve brenda NSPP. Ndryshimet pasqyrohen në VKM nr. 70, datë 14.02.2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 887/2022 ‘Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike’”.

SASPAC po bashkëpunon ngushtë me projektin “BE për Qeverisjen e Mirë” për përmirësimin e metodologjisë për renditjen e projekteve, raportimin dhe monitorimin e NSPP-së. Parashikohet që këto procedura të ndryshohen në vitin 2025.

Objekti i Specifik 2.4 Financat Vendore

¹⁸ Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) Nr. 359, datë 05.11.2024.

Treguesit e Performancës

Qeveria ka avancuar ndjeshëm në zhvillimin e mëtejshëm të formulës për transfertat e pakushtëzuara nga qeveria qendrore drejt Njësive të Qeverisjes Vendore, duke përdorur të dhënat më të fundit të Regjistrimit të Popullsisë për llogaritjen e transfertave në buxhetin e vitit 2025. Pas miratimit të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2024, numrat e popullsisë u përdorën për të përcaktuar transfertat e pakushtëzuara për bashkitë për vitin fiskal 2025. Drejtoria e Financave Vendore (në Ministrinë e Financave) do të vazhdojë të rishikojë dhe të përmirësojë formulën gjatë vitit 2025 për buxhetin e vitit 2026.

Sa i përket skemës shtesë të granteve të bazuara në performancë (SGBP), në vitin 2024 u diskutua skema e grantit të performancës dhe granti ishte pjesë e ligjit të buxhetit që u miratua në dhjetor 2024. U vendos që SGBP të jetë pjesë e ligjit të buxhetit për vitin 2025. Një udhëzim i ri ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor do të përgatitet gjatë muajve janar-shkurt 2025, për procesin e alokimit të këtyre fondeve për bashkitë.

Zbatimi i Sistemit të ri për Menaxhimin e Buxhetit Vendor (SMBV) ka qenë shumë i suksesshëm dhe deri në fund të vitit 2024, 80% e të gjitha bashkive kanë përdorur këtë sistem informatik për përgatitjen e PBA 2025–2027 dhe buxhetit, kundrejt objektivit fillestar prej 30%.

Në vitin 2024, sistemi i ri online u bë plotësisht funksional dhe iu prezantua të gjitha bashkive. U zhvilluan 5 takime rajonale për të trajnuar 61 bashki dhe 12 qarqe mbi përdorimin e Sistemit të ri të Menaxhimit të Buxhetit për përgatitjen e PBA 2025–2027.

Masat dhe Aktivitetet

Të gjitha aktivitetet që kontribuojnë në përmirësimin e formulës së granteve dhe sistemit të llogaritjes për qeverisjen vendore, si dhe në forcimin e formulimit dhe monitorimit të zbatimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) në Bashkitë, kanë ecur në rrugën e duhur. Udhëzuesi për PBA-në 2025–2027 është përgatitur, pjesë e të cilit është edhe një sistem i ri online për përgatitjen e PBA-së në nivel vendor, Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV). Gjithashtu, lista e produkteve standarde, që lidhen me të gjitha funksionet e NjQV-ve të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, është krijuar për 12 bashki pilote. Përshkrimi i programeve sipas klasifikimeve buxhetore është standardizuar përmes sistemit të ri online.

Në vitin 2024, Drejtoria e Financave Vendore ka vijuar zhvillimin e modulit të monitorimit të SMBV, i cili pritet të përfundojë në vitin 2025.

Në vitin 2024, për formulimin e PBA 2025–2027, të gjitha bashkitë kanë përdorur treguesit e performancës. Me shtimin e 3 bashkive të reja në vitin 2024, gjithsej 12 bashki po hartojnë PBA-në sipas metodologjisë së re deri në nivelin e produkteve.

Për të zhvilluar dhe zbatuar aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për formulimin e PBA-së, raportimin e zbatimit të buxhetit gjatë vitit dhe raportimin vjetor të ekzekutimit të buxhetit, MF ka organizuar trajnime rajonale me të gjithë drejtorët e buxhetit të bashkive.

Për të zhvilluar dhe vënë në funksion sistemin e ri SMBV për përgatitjen dhe monitorimin e buxhetit vendor, një dokument specifik i detajuar për përdorimin e SMBV u bë pjesë e Udhëzimit nr. 3/2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025–2027”¹⁹.

Sistemi i ri online për SMBV u testua plotësisht, u bë funksional dhe u prezantua tek të gjitha bashkitë. Për të mbështetur zbatimin e SMBV, është realizuar një program i gjerë ngritjeje kapacitetesh, i cili përfshiu 5 takime rajonale për trajnimin e 61 bashkive dhe 12 qarqeve mbi përdorimin e Sistemit të ri për Menaxhimin e Buxhetit Vendor për përgatitjen e buxhetit 2025–2027. Paralelisht me zhvillimin dhe zbatimin e SMBV, parashikohet integrimi i menaxhimit të buxhetit vendor në SIMFSH. **Zhvillimi i specifikimeve të SIMFSH, bazuar në përvojën me software-in online të PBA-së, është pjesërisht në rrugën e duhur.** Bashkitë do të vazhdojnë të përdorin software-in SMBV deri në momentin kur Moduli i Buxhetit Vendor në SIMFSH të bëhet funksional.

¹⁹ Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 3, datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”

Rishikimi, miratimi dhe konsolidimi i metodologjisë për komponentin e taksave personale në ndarjen e të ardhurave mes Qeverisë Qendrore dhe NJQV-ve planifikohet të nisë në vitin 2025. Qëllimi i këtij aktiviteti është përmirësimi i nivelit të burimeve financiare për njësitë e qeverisjes vendore nga taksat e ndara.

Objektivi Specifik 2.5 Raportimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Buxhetit

Treguesit e Performancës

Në përgjithësi, monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit po përmirësohet gradualisht dhe aktivitetet po zbatohen kryesisht sipas planit. **Sa i përket Monitorimit dhe Raportimit të Zbatimit të Buxhetit, për vitin 2024, sipas draft Raportit të vlerësimit të PEFAs, vlera faktike për Treguesin e Performancës 28 “Raportet e buxhetit gjatë vitit” është vlerësuar me D+.**

Formatet për Raportet e Zbatimit të Buxhetit për Qytetarët janë finalizuar. Raporti i Zbatimit të Buxhetit për Qytetarët do të prezantohet për herë të parë në vitin 2025, si pjesë e Raportit Vjetor të Zbatimit të Buxhetit që mbulon vitin fiskal 2024. Raporti i zbatimit të buxhetit për qytetarët është hartuar për të komunikuar informacionin financiar thelbësor të përfshirë në Raportin Vjetor të Zbatimit të Buxhetit, në një formë të qartë dhe lehtësisht të përdorshme, duke siguruar që qytetarët ta kuptojnë lehtësisht se si menaxhohen fondet publike.

Sa i përket numrit të kontratave PPP të mbuluara në raportin vjetor të përmbledhur për PPP-të dhe kontratat koncesionare, për vitin 2024 pritet të përfshihen më shumë sesa në raportin e vitit të kaluar (2023), konkretisht mbi 135 kontrata koncesionare.

Masat dhe Aktivitetet

Për të përmirësuar raportimin dhe monitorimin e zbatimit të buxhetit, si dhe prezantimin e raportit të Zbatimit të Buxhetit për Qytetarët, në këtë fazë nuk janë të nevojshme ndryshime ligjore për këtë masë. Raporti i zbatimit të buxhetit për qytetarët është hartuar për të komunikuar informacionin financiar thelbësor që përfshihet në Raportin Vjetor të Zbatimit të Buxhetit. Përmbajtja/formati i raportit vjetor të zbatimit të buxhetit është përcaktuar tashmë në nenin 63 të Ligjit Organik të Buxhetit.

Për monitorimin dhe raportimin e Projekteve të Investimeve Publike, njësitë e qeverisjes qendrore raportojnë pranë Ministrisë së Financave sipas VKM nr. 887/2022²⁰. Sa i përket përshtatjes së SIMFSH për të reflektuar ndryshimet e lidhura me procedurat e reja të miratuara për MIP, është ngritur një grup pune me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t nr. 359, datë 05.11.2024 dhe po ndiqen kërkesa konkrete për ndryshimet. Për këtë qëllim, po negociohet një kredi me Bankën Botërore në kuadër të projektit GovTech 2, ku një nga komponentët është ndryshimi i modulit MIP në SIMFSH. Ky proces nuk u përfundua, pasi gjatë vitit 2024 procedurat e MIP u rishikuan me VKM nr. 70, datë 14.02.2024 dhe nga diskutimet me Bankën Botërore dhe AKSHI, u konstatua se ndryshimet që duhej të bëheshin në SIMFSH ishin më shumë se ato të parashikuara fillimisht. Sa i përket aktiviteteve të trajnimit për monitorimin dhe raportimin e Projekteve të Investimeve Publike, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike është rënë dakord që trajnimet e nisura që prej vitit 2024 të vijnë në vitin 2025.

Ndryshimet për përditësimin e legjislacionit mbi PPP-të dhe akteve nënligjore përkatëse, me qëllim sigurimin e monitorimit dhe raportimit adekuat në nivel kontrate dhe portofoli/programi, janë ngushtësisht të lidhura me ndryshimet në ligjin për koncesionet. Drejtoria e Koncesioneve në Ministrinë e Financave ka përgatitur një draft, i cili do të koordinohet me ndryshimet që do të pësojë ligji.

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm

Nuk ka pasur sfida kryesore, pasi që të gjitha aktivitetet janë përfunduar dhe janë në rrugën e duhur, përveç aktiviteteve që kontribuojnë në përmirësimin e mëtejshëm të metodave, procedurave dhe llogaridhënies menaxheriale për formulimin e PBA-së, si dhe për përmirësimin e nivelit të burimeve financiare nga taksat e

²⁰ Aneksi nr. 2 i vendimit nr. 887, datë 27.12.2022 “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”, i ndryshuar.

ndara. Aktiviteti i lidhur me përhapjen e kuadrit të përditësuar të llogaridhënies menaxheriale përmes pilotimeve, rritjes së aktiviteteve dhe trajnimeve nuk ka filluar ende. Ky aktivitet pritet të zhvillohet pas miratimit të legjislacionit të rishikuar.

3.3 Progresi në Shtyllën 3 “Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave”

Reformat që synojnë përmirësimin e sistemeve për mobilizimin dhe menaxhimin e të ardhurave kanë vazhduar gjatë vitit 2024, në përputhje me planin e veprimit të MFP-së, Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave (SAA) dhe Strategjinë e Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare. Të gjitha objektivat e TP-ve janë arritur gjatë vitit 2024.

Tabela më poshtë përmbledh statusin e arritjes së treguesve të performancës për Shtyllën 3 Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave.


Tabela 4: Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 3

Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2024	Vlera faktike 2024
Objektivi Specifik (Komponenti) 3.1: Menaxhimi i taksave				
1	Rritja e të hyrave nga SSA (në total nga administrata tatimore dhe doganore sipas SAA-së)	(2023) 0.57% e PBB-së	0.76% e PBB-së rritje në krahasim me vitin 2023	Rritja e të ardhurave nga SSA në masën 0.79% e PBB-së.
2	Miratimi i SAA		Miraturar	Miraturar
3	Rritja e të hyrave nga TVSH-ja (e matur në bazë jokumulative)	2023 1,98% e PBB-së	0.4% e PPB rritje në krahasim me vitin 2023	0.41% ²¹
4	Rritja e të ardhurave nga reduktimi i punës së nëndeklaruar dhe të padeklaruar (e matur në bazë jokumulative) si rezultat I futjes së 40 mijë punonjësve të rinj në skemë dhe rritja e deklarimit të pagës së 120 mijë punonjësve, sipas kalendarit të rritjes në SAA	(2023) 0.08 e PBB-së	0.02% e PBB-së në krahasim me vitin 2023	Rritje 0.033% e PBB-së krahasuar me vitin 2023
Objektivi Specifik (Komponenti) 3.2: Menaxhimi i taksës së pasurisë ²²				
Objektivi Specifik (Komponenti) 3.3: Menaxhimi Doganor				
1	Përqindja e shfrytëzimit të Kanalit të Gjelbër	-	30%	31%
2	Koha e përpunimit të deklaratës doganore	-	Trend rënës	90
3	Numri i operatorëve ekonomikë të autorizuar	-	Trend rritës	16

Progres i kënaqshëm është bërë edhe drejt përfundimit të aktiviteteve të planifiluara për vitin 2024. 71.43% janë në rrugën e duhur, 4.76% nuk kanë filluar ende dhe 23.81% e aktiviteteve janë përfunduar.

Grafiku 9: Statusi për vitin 2024 të aktiviteteve në shtyllën 3

²¹ PBB e rishikuar për vitin 2024 është 2,494,208.4 milionë lekë.
²² Për Objektivin Specifik (Komponentin) 3.2 – Menaxhimi i Taksës së Pasurisë, nuk janë përcaktuar vlera objektivi për vitin 2024.



Progresi i Komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2024

Objektivi Specifik 3.1 Menaxhimi i Taksave

Treguesit e Performancës

Qeveria ka vijuar reformat në menaxhimin e taksave dhe është miratuar një Strategji e re Afatmesme për të Ardhurat (SAA), e cila paraqet masat për rritjen e mobilizimit të të ardhurave të brendshme. Ndërkohë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka rritur të ardhurat nga TVSH-ja, ka ulur hendekun e pajtueshmërisë së TVSH-së dhe ka reduktuar punën e nëndeklaruar dhe atë të padeklaruar.

Sa i përket rritjes së të ardhurave nga SAA (në total nga administrata tatimore dhe doganore sipas SAA-së), të ardhurat shtesë nga SAA arritën në 0.79% të PBB-së, krahasuar me 0.76% të parashikuara fillimisht. Kjo rritje e konsiderueshme e të ardhurave është kryesisht rezultat i performancës së fortë në kuadër të shtyllës për Përmirësimin e Administratës Tatimore.

Sa i përket rritjes së të ardhurave nga reduktimi i punës së nëndeklaruar dhe asaj të padeklaruar (të matur në bazë jo kumulative), SAA ka parashikuar përfshirjen e 40,000 punonjësve të rinj në skemë dhe rritjen e deklarimit të pagave për 120,000 punonjës gjatë periudhës 2024–2027. Për vitin 2024, SAA ka parashikuar përfshirjen e 1% të fuqisë punëtore totale ose 8,000 kontribues të rinj në skemë si dhe rritjen e pagave për rreth 2% të punonjësve total ose rreth 15,000 punonjës. Bazuar në të dhënat faktike për vitin 2024, rezultoi se këta dy tregues janë arritur plotësisht. Për vitin 2024, janë përfshirë 12,500 punonjës të rinj në skemën e kontributeve, që përfaqëson 1.6% të fuqisë punëtore totale, duke tejkaluar objektivin fillestar prej 1% të parashikuar në kuadrin strategjik për vitin. Për më tepër, është aplikuar një rritje e pagës prej 7,000 lekësh për afërsisht 27,000 punonjës, që përfaqëson 3.6% të popullsisë së punësuar, krahasuar me 2% të parashikuar fillimisht për vitin 2024.

Në vitin 2024, Ministria e Financave hartoi Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave dhe Planin e Veprimit 2024–2027. SAA u miratua me VKM²³ nr. 847/2024. Pas miratimit të SAA dhe Planit të Veprimit 2024–2027, për monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie, është ngritur një komitet drejtues dhe një sekretariat teknik me Urdhër të Ministrit²⁴. Sipas Urdhrit të Ministrit, Raporti i Monitorimit të SAA për vitin 2024 u miratua në mars 2025 dhe pritet të përdoret si instrument monitorimi.

Të ardhurat e brendshme nga TVSH-ja arritën në 2.39% të PBB-së në vitin 2024, duke shënuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2023, kur i njëjti tregues ishte 1.98% e PBB-së. Llogaritja

²³ VKM Nr. 847/2024 ‘Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe Planit të Veprimit 2024-2027’, datë 26 dhjetor dhe botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 2, datë 9 janar 2025.

²⁴ Urdhri Nr. 14, datë 24 Janar 2025, ‘Për krijimin e Komitetit Drejtues dhe Sekretariatit Teknik për procesin e monitorimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe Planit të Veprimit 2024-2027’, i Ministrit të Financave.

bazohet në të dhënat paraprake për vitin 2024 të PBB-së së rishikuar, e cila arrin në 2,494 miliardë lekë, dhe të ardhurat e brendshme nga TVSH-ja, që arrijnë në 59.6 miliardë lekë. Objektivi është arritur.

Masat dhe aktivitetet

Aktivitetet që kontribuojnë në miratimin e SAA 2024-2027 janë përfunduar. SAA dhe Plani i Veprimit 2024-2027 janë miratuar me VKM nr. 847, datë 26.12.2024. FMN-ja ofroi mbështetje të konsiderueshme për hartimin e SAA-së dhe do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për monitorimin e zbatimit të saj. Përveç kësaj, FMN-ja do të ndihmojë në vlerësimin e të gjitha përjashtimeve tatimore.

Në vitin 2024, Ministria e Financave krijoi një drejtori të re “Drejtoria e Programimit, Statistikës dhe Analizës së të Ardhurave Tatimore”, me synim forcimin e kapaciteteve institucionale në zhvillimin e politikave tatimore dhe menaxhimin e reformave fiskale. DPT ka përmirësuar më tej cilësinë dhe saktësinë e analizës së të dhënave. FMN-ja ka ofruar asistencë thelbësore përmes trajnimit të personelit dhe lehtësimit të përdorimit të programit R, një nga mjetet më efektive për analizat statistikore dhe përpunim të të dhënave. Për më tepër, DPT ka marrë pjesë në disa takime mbi inteligjencën artificiale (IA), të organizuara nga Microsoft, të cilat kanë ofruar udhëzime dhe njohuri të vlefshme për integrimin e IA në proceset analitike.

Me synim zhvillimin dhe zbatimin e nismave për reduktimin e hendekut të pajtueshmërisë së TVSH-së, u bë plotësisht funksional Komiteti i Riskut²⁵ dhe u operacionalizua moduli i riskut për identifikimin e mospajtueshmërisë. Komiteti i Riskut zhvilloi 12 mbledhje gjatë vitit 2024, duke shqyrtuar mesatarisht tetë çështje për çdo vendim. Në çdo mbledhje u mor një vendim për t’u dhënë Drejtorive Rajonale ose departamenteve të tjera të DPT-së, si hetimi apo verifikimi në terren, lista të tatimpaguesve me risk për t’u kontrolluar. DPT vijoi të operacionalizojë plotësisht modulin e riskut për anomalitë, i cili merr të dhëna nga sistemi i fiskalizimit. Deri në fund të vitit 2024, 46 kritere risku u testuan dhe u miratuan në modulin e riskut. Gjithashtu, janë krijuar katër raporte të Inteligjencës së Biznesit që janë plotësisht funksionale në modulin e Fiskalizimit. Të dhënat e fiskalizimit përdoren rregullisht për identifikimin e mospajtueshmërisë së TVSH-së, dhe DPT ka nisur zbatimin e deklaratave të paraplotësuara të TVSH-së, të cilat pritet të përfundojnë deri në fund të vitit 2026.

Ministria e Financave ka përfunduar zbatimin e një qasjeje të integruar për reduktimin e punës së nëndeklaruar dhe asaj të padeklaruar përmes forcimit të dispozitave ligjore për sanksionet që lidhen me punonjësit e padeklaruar dhe nëndeklarimin e të ardhurave. Ndryshimet e nevojshme ligjore u miratuan si pjesë e paketës fiskale 2023, konkretisht në nenin 119, pika 3 e Ligjit për Procedurat Tatimore.

Në vitin 2024, u miratua Plani i Përputhshmërisë për Deklaratën Vjetore të Tatimit mbi të Ardhurat Individuale për vitin 2022, duke synuar 100 individë me të ardhura të larta. U identifikuan risqet e lidhura me këtë grup. Hapat e ardhshëm përfshijnë auditimin e 200 individëve, që është gjithashtu një objektiv në Agjendën e Reformës, si dhe vlerësimin tatimor për individët me mospërputhje në deklaratat e tyre të të ardhurave ose që nuk justifikojnë pasuritë e tyre. Për më tepër, u dërguan letra për të gjithë individët që kishin mospërputhje në deklaratën e tyre DIVA 2021. Njësia e Hetimit Tatimor dërgoi letra për individët jo-përputhës, të cilët më pas u identifikuan dhe u shqyrtuan. Këto letra i referohen individëve që kishin detyrimin të deklaronin të ardhurat e tyre, por nuk janë individët më të pasur. Gjithashtu, për të lehtësuar ndjekjen e individëve jo-përputhës, gjatë vitit 2024 u identifikuan institucionet që do të marrin letra deri në vitin 2025.

Me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për tatimpaguesit, DPT po harton një strategji për shërbimin ndaj tatimpaguesve. Po kryhet punë intensive për përgatitjen strategjisë për shërbimin ndaj tatiompaguesve, e cila do të përfundojë në qershor 2025, në bashkëpunim me Administratën Tatimore Suedeze (STA). Fokusi i strategjisë do të jetë “Përmirësimi i funksioneve të shërbimit ndaj tatimpaguesve përmes shërbimeve të reja online dhe një infrastrukture teknike moderne”. Qëllimi i kësaj strategjie është rritja e besimit dhe produktivitetit.

²⁵ Me Urdhrin Nr. 42 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), datë 23 Shkurt 2023. Komiteti i Përputhshmërisë, u zëvendësua nga një Komitet i Riskut që merr vendime në baza mujore.

Përmirësimi i efikasitetit të qendrës kombëtare të thirrjeve, me një proces të strukturuar përshkallëzimi për trajtimin e kërkesave me kompleksitet të ndryshëm, ka përfunduar. Qendra e thirrjeve është plotësisht funksionale dhe është përfshirë në të gjitha iniciativat e administratës tatimore që lidhen me promovimin e vetëpërputhshmërisë së tatimpaguesve. Administrata tatimore është gjithashtu në procesin e zbatimit të disa iniciativave trajnimit të hartuara për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore. Disa nga programet kryesore të trajnimit përfshijnë ato të ofruara nga QTATD, CEF, FMN, AIOTA dhe TAIEK. Këto trajnime fokusohen në ndërtimin e qëndrueshëm të kapaciteteve për qëllime të administratës tatimore.

Objektivi Specifik 3.2 Menaxhimi i Taksës së Pasurisë

Treguesit e Performancës

Sa i përket Menaxhimit të Taksës së Pasurisë, nuk ka pasur vlera të synuara të përcaktuara për vitin 2024. Qeveria ka vazhduar procesin e reformës në Menaxhimin e Taksës së Pasurisë. Lidhur me ligjin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, të miratuara bazuar në VKM nr. 818/2024, projektligji parashikohet të paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025. Pasi ky ligj i ri të miratohet, Ministria e Financave do të nisë hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore përkatëse.

Masat dhe aktivitetet

Të dy aktivitetet që kontribuojnë në përmirësimin e kadastrës fiskale dhe sistemit të mbledhjes së taksës së pasurisë janë në rrugën e duhur. Është hartuar një ligj i ri për Taksën mbi Pasurinë e Paluajtshme, i cili ka kaluar procesin e konsultimit publik, përfshirë seancat dëgjimore publike. Për më tepër, partnerët ndërkombëtarë FMN dhe BB kanë shqyrtuar projektligjin. Pas këtij procesi shqyrtimi dhe konsultimi, janë bërë përmirësime në projektligj. Projektligji “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme”, ndër të tjera, parashikon: (i) kalimin nga tatimi i bazuar në sipërfaqe në tatimin e bazuar në vlerën e tregut; (ii) autoritetet kompetente për vlerësimin e pasurive të paluajtshme për qëllime të llogaritjes së tatimit mbi pasurinë; (iii) përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë dhe Bashkive; (iv) kategoritë e pasurive që do të taten; (v) normat e tatimit mbi pasurinë; (vi) përjashtimet nga taksa e Pasurisë; (vii) gjrobat; (viii) bashkëpunimin ndërinstitucional për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për llogaritjen e tatimit mbi pasurinë. Bazuar në VKM nr. 818/2024 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025”, projektligji parashikohet të paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025.

Objektivi Specifik 3.3 Menaxhimi i Doganave

Treguesit e Performancës

Qeveria vazhdoi reformat në Menaxhimin Doganor, duke rezultuar në uljen e kohës së përpunimit të deklaratave doganore, përmirësimin e përdorimit të kanalit të gjelbër dhe rritjen e numrit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (OEA).

Përdorimi i kanalit të gjelbër ishte 31% gjatë vitit 2024. Në kuadër të promovimit të tregtisë së ligjshme, si dhe të ruajtjes së kontrolleve të bazuara në risk për mallrat, mjetet e transportit apo personat, Doganat gjatë vitit 2024 janë angazhuar në rritjen e përdorimit të kanalit të gjelbër (pa kontroll) dhe në uljen e përdorimit të kanalit të kuq (kontroll fizik). Kjo ka rritur numrin e kompanive të Listës së Gjelbër, i cili për vitin 2024 ka arritur në 2,200, si dhe ka sjellë një fokusim më të mirë të kontrolleve fizike. Nga të dhënat statistikore rezulton se niveli i përdorimit të kanalit të gjelbër në vitin 2024 është rreth 30.73%, kundrejt 27.9% në vitin 2023. Niveli i kontrollit në kanalin e kuq (kontroll fizik) është 6.57%, kundrejt 6.64% në vitin 2023. Si përfundim, në vitin 2024 ka pasur një rritje të nivelit të përdorimit të kanalit të gjelbër.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) reduktoi me sukses kohën e përpunimit të deklaratave doganore nga 99.1 minuta mesatarisht në vitin 2023 në 90 minuta në vitin 2024. Ky reduktim rezultoi nga përshtetja e përpunimit në të tre kanalet (të kuq, të verdhë dhe të gjelbër), si rezultat i procedurave të kontrollit të përmirësuara dhe më efikase.

Në vitin 2023, numri i Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar ishte 13 (nga 13 të planifikuar), si rezultat i vijimit të aplikimeve të suksesshme nga operatorët ekonomikë dhe kryerjes në kohë të kontrolleve dhe miratimeve nga grupi i punës së Doganave. **Për vitin 2024, tre kompani të tjera morën statusin OEA nga Doganat.** Numri i OEA-ve u rrit nga 13 në vitin 2023 në 16 në vitin 2024.

Masat dhe aktivitetet

Sa i përket Menaxhimit Doganor, të gjitha aktivitetet janë në rrugën e duhur. Vetëm zhvillimi i një zgjidhjeje TI për zbatimin e Dritares së Vetme Kombëtare po përjeton disa vonesa.

Sa i përket përmirësimit të praktikave të Burimeve Njerëzore dhe zhvillimit të kapaciteteve, trajnimet për punonjësit ekzistues dhe të saporekrutuar realizohen në mënyrë të vazhdueshme.

Sa i përket investimeve në sistemet TI për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Tarifave (SIMT), gjatë vitit 2024 u krijuan modulet e sistemit. Më pas u kryen testimet përkatëse për këto module. Nga ana e kontraktorit u dorëzuan versionet e printuara dhe elektronike të materialeve. Kodi i programit u vu në dispozicion në një njësi ruajtjeje. Nga projekti është hequr pjesa e mirëmbajtjes, pasi ky periudhë njëvjeçare do të shërbejë si fazë testuese, gjatë së cilës do të verifikohen mangësitë e fundit që mund të ketë sistemi, me qëllim që të përgatitet për fazën e zbatimit. Të dy kontratat, ajo e asistencës teknike dhe ajo e furnizimit, janë mbyllur.

Në përputhje me kërkesat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, DPD hartoi dhe miratoi Planin e Integritetit. Gjithashtu, u zhvillua dhe u miratua Regjistri i Riskut për Doganat. Plani i Integritetit monitorohet rregullisht nga Drejtoria Antikorrupsion në DPD. Regjistri i Riskut hartohet dhe zbatohet çdo vit dhe monitorohet nga Grupi i Menaxhimit Strategjik brenda DPD-së.

Aplikimet e operatorëve ekonomikë janë të vazhdueshme, po ashtu edhe kontrollet dhe miratimet nga Doganat për marrjen e statusit OEA. Në total, me vitin 2024 u validuan 16 aplikime të suksesshme. 16 kompani operojnë me statusin OEA.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) dhe DPD vijuan përgatitjet për zbatimin e Dritares së Vetme Kombëtare.

Një projekt i Bankës Botërore ka nisur në tetor 2020 dhe është ende në vazhdim. Ky projekt synon të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin e proceseve të tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor, duke u përqendruar në përmirësimin e integritetit rajonal dhe uljen e pengesave për tregtinë ndërkufitare. Në vitin 2024, u kontraktua një kompani për të rishikuar dhe ndryshuar legjislacionin dhe rregulloret për “Udhëzuesin e Dritares së Vetme Kombëtare për Shqipërinë” dhe për të hartuar specifikimet teknike për sistemin informatik të Dritares së Vetme Kombëtare (DVK). Ky Udhërrëfyes do të shërbejë si bazë për zhvillimin e dritares së vetme kombëtare, një pikë e vetme hyrëse, plotësisht elektronike, që mbulon të gjitha kërkesat rregullatore të lidhura me tregtinë. Kjo rezultoi në hartimin e Termave të Referencës për një projekt pasues, i cili synon të finalizojë zbatimin e DVK. Këto terma reference janë miratuar nga Banka Botërore, e cila do të financojë fazën e ardhshme. Pritet që procedura e tenderimit të hapet në shtator 2025.

Janë ndërmarrë hapa të mtejshëm me përdorimin e Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transistit (SRKT) dhe në vitin 2024 është përzgjedhur një kontraktor për zhvillimin e aplikacionit Kombëtar të Transistit. Reforma për SRKT ka filluar në vitin 2020 si pjesë e projektit të mbështetur nga Banka Botërore për Shërbimet e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit të Cilësisë për zbatimin e plotë të SRKT në Shqipëri²⁶. Në vitin 2024, MEKI dhe CFCU kontraktuan një kompani për zbatimin e kontratës mbi Arkitekturën dhe Zbatimin e Aplikacionit Kombëtar të Transistit, plotësisht të përputhshëm me standardet e BE-SRKT²⁷.

²⁶ Shërbimet e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit të Cilësisë për zbatimin e plotë të SRKT në Shqipëri, Nr. Ref. WBTF-ALB-121D, datë 03.06.2022.

²⁷ Architecture and Deployment of the National Transit Application, fully compatible with EU-NCTS, Ref. No. WBTF-ALB-121B.

Për të avancuar më tej mjedisin TI të SRKT, AD ka krijuar një grup pune për zbatimin e Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transitit. Ky grup përbëhet nga ekspertë të fushave të ndryshme, përfshirë procedurat doganore, çështjet ligjore, garancitë, pagesat, teknologjinë e informacionit dhe menaxhimin e riskut.

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm

Nuk ka pasur sfida kryesore, pasi të gjitha aktivitetet janë të përfunduara dhe në rrugën e duhur, përveç zhvillimit dhe implementimit të zgjidhjes TI për Dritaren e Vetme Kombëtare, e cila ende nuk ka nisur. Koha e fillimit të kësaj veprimtarie varet nga dy aktivitetet e tjera të lidhura me zbatimin e DVK.

3.4 Progresi në Shtyllën 4 “Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit”

Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit ka treguar përmirësim të ndjeshëm, me shumicën e objektivave të TP-ve të planifikuara për vitin 2024 që janë arritur. Aksesit i institucioneve Buxhetore në Arkivin Elektronik i tejkaloi pritshmëritë. Një numër shtesë prej 144 institucioneve të reja janë lidhur me Arkivin Elektronik gjatë vitit 2024. Si pjesë e menaxhimit të borxhit dhe të likuiditetit, janë përgatitur dhe publikuar Plani Vjetor i Huamarrjes dhe Raporti i Monitorimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB) dhe është konsoliduar norma e saktësisë së parashikimit mujor të likuiditetit. Për më tepër, përqindja e kontabilistëve qeveritarë që kanë përfunduar trajnimet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) është përmirësuar më tej me 380 auditorë të brendshëm të sektorit publik të trajnuar mbi parimet dhe konceptet themelore të kontabilitetit aktual bazuar në SNKSP, si pjesë e Zhvillimit të tyre të Vazhdueshëm Profesional. Për herë të parë në vitin 2024, në Parashikimin e Fluksit të Likuiditetit për vitin 2024 ka 6 zëra të detajuar të hyrjeve dhe 4 zëra të detajuar të daljeve. Përveç kësaj, numri i instrumenteve për menaxhimin aktiv të likuiditetit u rrit me 2 instrumente. Përmirësimi i menaxhimit të aseteve është i lidhur drejtpërdrejt me fazën e dytë të zbatimit të SNKSP. Kjo fazë filloi në vitin 2024, me konsulentë të angazhuar në hartimin e kuadrit rregullator bazuar në SNKSP, duke përfshirë ligjin për kontabilitetin e sektorit publik, udhëzimet dhe manualët për transaksionet financiare.

Deri në fund të vitit 2024, u arritën **62.50% e objektivave të TP-ve për Shtyllën 4: Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit, 25% u arritën pjesërisht dhe 12.50% të përcaktuar**. Tabela më poshtë paraqet statusin e arritjes së treguesve të performancës për Shtyllën 4.

Tabela 5: Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të shtyllës 4

Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2024	Vlera faktike 2024
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.1 Llogaritë Kombëtare të Qeverisë ²⁸				
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.2 Kontabiliteti				
1	Numri shtesë i Institucioneve Buxhetore që kanë akses në SIFQ dhe arkivën elektronike (AE).	-	86 në AE	144 në AE
4	Përqindja e kontabilistëve të qeverisë që kanë përfunduar trajnimin SNKSP	-	60%	60%
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.3 Prokurimi Publik ²⁹				
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.4 Menaxhimi i Borxhit				


²⁸ Për komponentin 4.1 Llogaritë Kombëtare të Qeverisë, asnjë vlerë e synuar nuk ka qënë vendosur për 2024.

²⁹ Për komponentin 4.3 Prokurimi Publik, asnjë vlerë e synuar nuk ka qënë vendosur për 2024.

1	Plani Vjetor i Huamarrjes dhe Raporti i Monitorimit i SMB-së i përgatitur dhe publikuar	-	Dokumentet e publikuara në faqen zyrtare të MF-së	Dokumenti i raportit të monitorimit të SAMB përgatitur dhe publikuar. Plani Vjetor i Huamarrjes përgatitur dhe publikuar.
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.5 Menaxhimi i Likuiditetit				
1	Norma e saktësisë së parashikimit mujor të likuiditetit	88% (2022)	91%	90%
2	Zërat e detajuara të të hyrjeve dhe daljeve në Parashikimin e Flukseve të Likuiditetit të përfshira	0	6	6
3	Rritja e numrit të instrumenteve për menaxhim aktiv të likuiditetit	1	0	2
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.6 Menaxhimi i Aseteve				
1	Krijimi i kuadrit të duhur rregullator për vlerësimin dhe inventarizimin e asetëve publike	-	Kuadri rregullator i hartuar	Kuadri rregullator ka filluar hartimin
2	Përgatitja e një regjistri të konsoliduar të asetëve në institucionet qendrore, në nivel njësie kontrolluese.	-	Hartuar	Një regjistër i konsoliduar i asetëve ka filluar hartimin

Është bërë progres i kënaqshëm drejt përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2024 me 26.47% përfunduar dhe 38.24 % janë në rrugën e duhur.

Grafiku 10: 2024 Statusi për vitin 2024 të aktiviteteve në Shtyllën 4



Progresi i komponentëve (Objektivave Specifik) bërë gjatë vitit 2024

Objektivi Specifik 4.1 Llogaritë Kombëtare të Qeverisë

Treguesit e Performancës

Lidhur me "Llogaritë Kombëtare të Qeverisë", nuk ka patur target të parashikuar për Treguesit e Performancës për vitin 2024.

Masat dhe aktivitetet

Aktiviteti dhe masa e planifikuar për vitin 2024 u përfundua sipas afatit. Në këtë drejtim, Instituti i Statistikave (INSTAT) ka punuar për të përmirësuar më tej Statistikat Financiare të Qeverisë (SFQ) dhe Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (PDT) në përputhje me standardet e BE-së (SELL 2010) përmes mbledhjes dhe përfshirjes së informacionit mbi PPP-të dhe kontratat e koncesioneve në statistikën e SFQ dhe PDT. INSTAT është aktualisht në proces të mbledhjes së të dhënave mbi Partneritetet Publiko-Private (PPP) dhe koncesionet. Të gjitha kontratat e disponueshme janë ngarkuar nga faqja zyrtare e internetit e ATRAKO-s. Është krijuar një bazë të dhënash e dedikuar për koncesionet dhe PPP-të, dhe procesi i popullimit të sistemit është në fazën e tij fillestare.

Objektivi Specifik 4.2 Kontabiliteti

Treguesit e Performancës

Sistemi informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) mbetet instrumenti kryesor për kontrollin dhe monitorimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një numër shtesë prej 144 institucioneve të reja janë lidhur me Arkivin Elektronik në vitin 2024. Përdorimi i arkivit elektronik (portali web) është zgjeruar në vitin 2024 për të përfshirë 144 institucione të reja, duke e çuar numrin e përgjithshëm të institucioneve në 787. Për vitin 2024, zgjerimi i arkivit elektronik ishte planifikuar për 86 institucione buxhetore, ndërsa në realitet, numri i institucioneve që kanë aksesuar arkivin elektronik është 144. Kjo rritje ndodhi për shkak të: 1) Shumë prej institucioneve që nuk përmbushën rregullin e kontrollit të brendshëm financiar për transaksionet e procesit të zbatimit të buxhetit për të aksesuar arkivin elektronik kanë shtuar pozicionin e specialistit të financës në stafin e tyre; 2) Shtimit të institucioneve të sapo bashkuara në SIFQ.

Janë bërë përpjekje për të përmirësuar më tej përqindjen e kontabilistëve të qeverisë që kanë përfunduar trajnimet SNKSP. Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DHMFKK) arriti objektivin që 60% e kontabilistëve të qeverisë të përfundojnë trajnimet SNKSP. Një nga objektivat kryesore të fazës së parë të projektit SNKSP ishte ndërtimi i kapaciteteve të kontabilistëve të qeverisë në institucionet e sektorit publik. Në vitin 2024, DHMFKK trajnoi afërsisht 380 auditorë të brendshëm në sektorin publik mbi parimet dhe konceptet themelore të kontabilitetit në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara bazuar në SNKSP, si pjesë e Zhvillimit të tyre të Vazhdueshëm Profesional.

Masat dhe aktivitetet

Në vitin 2024, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka arritur progress të konsiderueshëm lidhur me aktivitetet për rritjen e aksesit dhe përdorimit të SIFQ. Në këtë drejtim, u zgjerua përdorimi i arkivit elektronik (portali web). Arkivi lehtëson dorëzimin elektronik të dokumentacionit mbështetës të skanuar dhe të nënshkruar elektronikisht për transaksionet buxhetore të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në Degët e Thesarit. Ky zgjerim përfshiu 144 institucione të reja buxhetore në vitin 2024, duke e çuar numrin total në 787 institucione. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 filloi puna për: 1) Automatizimin e procesit të kontrollit të shpenzimeve para angazhimit në institucionet buxhetore që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me përmirësimin e pajisjeve dhe softuerëve të SIFQ; dhe 2) Sigurimin e ndërveprimit të sigurt me sistemin e fiskalizimit për të

përmirësuar kontrollet e brendshme për të parandaluar detyrimet e prapambetura. Në këtë drejtim, dhe në përputhje me Aktin Normativ Nr. 3, datë 28.08.2024, është miratuar fondi për zbatimin e projektit "Përmirësimi i Sistemit të Informacionit Financiar të Qeverisë". Akti Normativ iu dorëzua Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për njohje dhe përpunim të mëtejshëm nëpërmjet një letre nga Ministria e Financave (Nr. 11696/115, datë 23.09.2024). Më pas, nëpërmjet letrës së AKSH-it Nr. 1815/3, datë 09.10.2024 "Mbi Procedurën për Përmirësimin e Sistemit të Thesarit", u kërkua një rishikim i termave të referencës së projektit. Më 05.12.2024 u finalizuan termat e referencës dhe kriteret e veçanta të kualifikimit dhe u përcaktua fondi limit për procedurën e lartpërmendur. Institucioni i AKSH-it është duke vazhduar me procedurat e prokurimit.

Gjatë vitit 2024, DHMFKK ka punuar për të përmirësuar zhvillimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për reformat e kontabilitetit. Është bërë përparim drejt zhvillimit të një Ligji të ri për Kontabilitetin Publik që prezanton këto reforma. Përveç kësaj, po bëhen përpjekje për të zhvilluar udhëzime/dhe akte nënligjore që mbulojnë të gjitha SNKSP -të e miratuara, së bashku me manualët përkatëse për secilin akt nënligjor. Objektivi strategjik përfundimtar i reformës është të sigurojë që institucionet e sektorit publik të përgatisin pasqyra financiare bazuar në SNKSP -të e përzgjedhura. Pas përfundimit të fazës së parë të Projektit të Kontabilitetit të Sektorit Publik në dhjetor 2022, një koncept dokument i projektit për zbatimin e metodologjisë së re të kontabilitetit në sektorin publik është hartuar në vitin 2023 në konsultim me Bankën Botërore dhe SECO-n. Një objektivi kryesor i kësaj faze të dytë është miratimi i një Ligji për Kontabilitetin e Sektorit Publik dhe akteve nënligjore përkatëse, të harmonizuara me SNKSP -të. **Faza e dytë e projektit filloi në vitin 2024 me konsulentë të angazhuar në procesin e hartimit të kuadrit rregullator bazuar në SNKSP (Ligji i Kontabilitetit të Sektorit Publik, si dhe udhëzime dhe manuale mbi transaksionet financiare).** Aktivitetet që lidhen me masën "Përgatitja, zbatimi dhe institucionalizimi i zhvillimit të kapaciteteve të kontabilistëve për të përthithur reformat e kontabilitetit" nuk kanë filluar ende në vitin 2024, pasi kjo masë lidhet me fillimin e fazës së dytë të projektit. Në vitin 2025, pas nënshkrimit të marrëveshjes së grantit me Bankën Botërore për fazën e dytë të projektit, puna do të vazhdojë për menaxhimin e ndryshimeve dhe ndërtimin e kapaciteteve. DHMFKK planifikon të nënshkruajë këtë marrëveshje në vitin 2025, konkretisht: (i) Zhvillimi i programit të trajnimit dhe ofrimi i trajnimeve për zyrtarët financiarë në sektorin publik dhe audituesit (Auditit i brendshëm dhe institucioni i auditit shtetëror) mbi Udhëzimet e reja të Kontabilitetit, proceset e brendshme, bilancin hapës dhe çështjet përkatëse të auditimit; (ii) Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimi për Thesarin dhe Institucionet Buxhetore mbi të gjitha aspektet e mësipërme (mund të përkufizohen si aktivitet i veçantë ose i integruar nën secilin element); (iii) Rritja e ndërgjegjësimit, ngjarjet e nivelit të lartë dhe aktivitete të tjera të menaxhimit të ndryshimeve.

Objektivi Specifik 4.3 Prokurimi Publik

Treguesit e Performancës

Nuk ka patur objektiva për Treguesit e Performancës për vitin 2024, megjithatë, ka patur progres në nivel aktiviteti, siç përshkruhet më poshtë.

Masat dhe aktivitetet

Masa mbi përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të procedurave të prokurimit është realizuar 2024. Aktiviteti që lidhet me përdorimin e kriterit të vlerësimit "oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto" (kriteret MEAT bazuar në kosto) është përfunduar. Në këtë drejtim, më 4 tetor 2024, u miratua udhërrëfyshi: "Mbi përdorimin e ofertës ekonomike më të favorshme bazuar në kosto - MEAT bazuar në kosto". Ky udhërrëfyes u hartua me mbështetjen e SIGMA-s dhe është një mjet për një përdorim më të mirë

të kritereve MEAT nga autoritetet kontraktuese. Udhërrëfyesi është publikuar në faqen e internetit të APP-së.³⁰

Masa mbi **hartimin dhe zbatimin e prokurimit publik të gjelbër (PPGJ)** është realizuar në vitin 2024 **sipas planit**. Në këtë drejtim, APP-ja ka rishikuar dhe ndryshuar kuadrin rregullator, konkretisht Udhëzimin e prokurimit të gjelbër "Mbi Zbatimin e Prokurimit Publik të Gjelbër në Procedurat e Prokurimit Publik" dhe metodologjinë "Për Zbatimin e Prokurimit Publik të Gjelbër në Shqipëri", të cilat janë miratuar dhe gjenden në faqen e internetit të APP-së³¹. Këto dy akte nënligjore janë hartuar me ndihmën e Bankës Botërore dhe bazohen në kuadrin ligjor të BE-së. Për më tepër, një dispozitë e re është shtuar me VKM Nr. 498, datë 01.08.2024 "Mbi disa shtesa dhe ndryshime të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar", ku në nenin 25 përcaktohet se, autoritetet/entitetet kontraktore, në hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, si dhe në hartimin e specifikimeve teknike, përveç rregullave të prokurimit publik, janë gjithashtu të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat e mëposhtme: a) Kërkesat minimale të performancës energjetike, siç përcaktohen në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burime të tjera të produkteve me ndikim në energji, duke përfshirë dispozitat për përdorimin e etiketave për produktet që kanë ndikim në energji; b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës, me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis; c) Çdo dispozitë tjetër që lidhet me legjislacionin mjedisor, energjetik, social dhe të punës.

Gjatë vitit 2024, APP ka zhvilluar dhe ofruar trajnime mbi prokurimin e gjelbër/efikasitetin e energjisë për profesionistët e prokurimit. Në këtë drejtim, gjatë semestrit të parë të vitit 2024, janë zhvilluar dy trajnime: 1) **Trajnimi i Trajnerëve mbi Prokurimin Publik të Gjelbër (PPGj)**, i zbatuar nën suportin e Bankës Botërore. Një mundësi për të nxitur rritjen e gjelbër në Shqipëri, i mbajtur më 22-23 prill 2024, ku janë prezantuar koncepti i Prokurimit Publik të Gjelbër dhe trendet dhe praktikat ndërkombëtare, detajet e planifikimit dhe hartimit të prokurimeve individuale të gjelbra, si dhe shtyllat e reformës efektive të prokurimit për Prokurim Publik të Gjelbër në nivel institucional dhe kombëtar. Gjatë këtij trajnimi, pjesëmarrësit nga APP-ja dhe institucione të tjera publike që merren me konceptet e gjelbra kanë diskutuar në mënyrë aktive në lidhje me konceptet e PPGj-së përmes këndvështrimit të Bashkimit Evropian dhe praktikës ndërkombëtare. 2) **Webinari i 5 janarit 2024, me temën "Prokurimi Publik i Gjelbër: Një qasje moderne strategjike ndaj prokurimit"**. Ky Webinar është mbajtur në kuadër të projektit të Bankës Botërore "Prokurimi Publik i Gjelbër (PPGj) në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore". Në këtë webinar u diskutua rreth rolit të PPGJ-së në arritjen e qëllimeve strategjike kombëtare, kontekstit ndërkombëtar dhe trendeve në lidhje me PPGJ-në, praktikave të mira të Bankës Botërore dhe përdorimit të "PPGj-së" në Shqipëri.

Gjatë vitit 2024, KPP ka rritur efikasitetin e sistemit të shqyrtimit të ankesave duke rritur shpejtësinë e vendimmarrjes. Gjatë vitit 2024, Komisioni i Prokurimit Publik, në kuadër të ushtrimit të detyrave të tij funksionale dhe thelbësore në përputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", dhe bazuar në Rezolutën e miratuar të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, "Për Vlerësimin e Aktivitetit të Komisionit të Prokurimit Publik për Vitin 2020", synon të vazhdojë procesin e dixhitalizimit të shërbimeve në fushën e prokurimit publik, koncesioneve, ankandeve dhe lejeve minerare. Gjatë vitit 2024, 6 nga 8 pozicionet vakante të shpallura sipas Planit Vjetor të Rekrutimit për Shërbimin Civil për vitin 2024 janë plotësuar, dhe 2 pozicione të tjera vakante janë hapur dhe plotësuar brenda të njëjtit vit. Gjithashtu, KPP ka zhvilluar dhe ofruar aktivitete të specializuara për ndërtimin e kapaciteteve për inspektorët. Konferenca dhe seminare janë organizuar nga Komisioni i Prokurimit Publik si në vend ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Konkretisht: i) Një seminar mbi prezantimin e Manualit të Përdoruesit për sistemin elektronik të ankesave për Operatorët Ekonomikë dhe Autoritetet Kontraktore; ii) Një seminar i organizuar nga KPP-ja në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) me temë: "Rreziqet e Integritetit në

³⁰ <https://app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=455cad8e-eda5-4b54-b227-ee3598810811>

³¹ <https://app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/udherrefyes/>.

Prokurimin Publik - Rasti Shqiptar dhe Praktikë Evropiane". Përveç kësaj, sesione të ndryshme trajnimi në lidhje me prokurimin u zhvilluan jashtë vendit, me pjesëmarrjen e stafit të KPP-së në vende të tilla si Ankaraja, Brukseli, Budapesti, Zagrebi, Luksemburgu, Roma, SHBA, Bosnja dhe Hercegovina, Shkupi, Sllovakia dhe Lubjana. Në përpjekje për të përmbushur standardet ndërkombëtare në menaxhimin e riskut të korrupsionit, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) ka përmbushur me sukses të gjitha kërkesat e përcaktuara nga ISO 37001:2016 për sistemet e menaxhimit kundër rryshfetit. Certifikimi u auditua nga ITA (Aleanca Teknike Ndërkombëtare), një institucion i akredituar nga ACCREDIA, Organi Italian i Akreditimit, një nga institucionet më prestigjioze në Evropë.

Objektivi Specifik 4.4 Menaxhimi i Borxhit

Treguesit e Performancës

Me zhvillimin dhe publikimin e Planit Vjetor të Huamarrjes 2025 dhe Raportit të Monitorimit të SAMB 2023, të gjitha objektivat e TP-ve janë arritur për vitin 2024 sikurse planifikuar. Raporti i Monitorimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit është përgatit nga Ministria e Financave në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Raporti i monitorimit i përgatitur nga Ministria e Financave iu dorëzua Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat dhe është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave në Mars 2024.³² Raporti monitorues paraqet një analizë mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit për vitin e kaluar. Publikimi i këtij raporti shërben si një hap pozitiv drejt rritjes së transparencës ndaj publikut të gjerë si dhe intensifikimit të komunikimit me investitorët apo palët e treta të interesuara. Plani Vjetor i Huamarrjes për vitin 2025 është hartuar bazuar në parashikimet e bëra në buxhetin e vitit 2025, analizat e hollësishme të kushteve të tregut, situatën e paraqitur gjatë gjithë vitit 2024, duke marrë parasysh ecurinë e ankandeve dhe normat e interesit. **Plani Vjetor i Huamarrjes për vitin 2025 u përgatit gjatë nëntorit-dhjetorit 2024 dhe u publikua në faqen e internetit të Ministrisë së Financave në dhjetor 2024**³³. Plani Vjetor i Huamarrjes është një dokument i hartuar me qëllimin kryesor rritjen e transparencës së Ministrisë së Financave në procesin e huamarrjes dhe financimit, si dhe informimin e investitorëve.

Masat dhe aktivitetet

Tre aktivitetet që kanë lidhje me forcimin e raportimit të menaxhimit të borxhit dhe marrëdhënieve me investitorët kanë progresuar sipas planit në 2024. Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Shtetëror (DPBSH) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Programimit Makroekonomik dhe Fiskal (DPPMF) rishikuan praktikën aktuale dhe përmirësuan informacionin për investitorët, si dhe e publikuan atë në faqen e internetit të Ministrisë së Financave³⁴. **Për herë të parë u përgatit dhe u publikua një buletin informues për investitorët mbi zhvillimet kryesore makroekonomike për vendin.** Dokumenti po përgatitet çdo tremujor bashkërisht nga DPBSH dhe DPPMF. Në vitin 2024 u publikua në faqen e internetit të Ministrisë së Financave, sipas afateve të përcaktuara. Ky publikim i parë bëhet në tremujorin e tretë të vitit 2024 dhe do të vazhdojë publikimet e tij periodike. Në tremujorin e tretë të vitit 2024, MF filloi punën sipas planit në lidhje me aktivitetin për t'u ofruar informacion investitorëve bazuar në zhvillimet kryesore makroekonomike në vend. **Për herë të parë, përmes komunikimit elektronik, një buletin informues u nda me të gjithë investitorët e listës së përgatitur më herët nga DPB në bashkëpunim me DPPMF.** Gjithashtu, Raporti i Monitorimit të Strategjisë SAMB për vitin 2023 u përgatit në mars 2024 dhe iu dërgua Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, si dhe u publikua në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave³⁵. Aktivitetet që

³² https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/04/Monitoring-Report-for-the-Medium-Term-Debt-Management-Strategy_Year-2023_English-Version.pdf

³³ <https://financa.gov.al/plani-vjetor-i-huamarrjes/>

³⁴ <https://financa.gov.al/buletini-makroekonomik-2/>

³⁵ https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/04/Monitoring-Report-for-the-Medium-Term-Debt-Management-Strategy_Year-2023_English-Version.pdf

lidhen me fillimin gradual të zhvillimit të vlerësimit të nevojshëm për instrumentet e reja alternative të financimit ((Instrumente të Gjëlbra, Sociale ose të Qëndrueshmërisë ose Instrumente të tjera) nuk filluan sipas planit në tremujorin e tretë të vitit 2024 për shkak të vonesës dhe disponueshmërisë së asistencës teknike dhe përfshirjes së kapaciteteve të duhura njerëzore. Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe ministritë e tjera të linjës, ka filluar përgatitjen e një draft-urdhëri ndërqeveritar për hartimin e kuadrit të obligacioneve të gjëlbra për Republikën e Shqipërisë (korrik 2024). Zbatimi i këtij aktiviteti është kushtëzuar në thelb nga disponueshmëria e asistencës teknike nga Banka Botërore, si dhe nga përfshirja e kapaciteteve të duhura njerëzore nga ministritë dhe institucionet e tjera përkatëse.

Objektivi Specifik 4.5 Menaxhimi i Likuiditetit

Treguesit e Performancës

Sa i përket Menaxhimit të Likuiditetit, dy tregues të performancës të vendosur për vitin 2024 janë përmbushur plotësisht me sukses, ndërsa një tregues nuk është përmbushur. Ka një rënie të normës së saktësisë së parashikimit mujor të likuiditetit që arriti në 90% në vitin 2024, që është më e ulët se plani (91%), por përfaqëson një përmirësim krahasuar me vitin 2023 (88%). Ky është një tregues që varet nga ecuria e shpenzimeve dhe të ardhurave mujore. Për herë të parë, në vitin 2024 ka gjashtë zëra të detajuar të hyrjeve (TVSH; tatim mbi fitimin; TAP; kontribute/sigurime; taksa të tjera; të ardhura doganore dhe jo-tatimore) dhe katër zëra të detajuar të daljeve (Shpenzime Personeli; Shpenzime Operacionale; Shpenzime Kapitale; Shpenzime të Tjera) në Parashikimin e Flukseve të Likuiditetit për vitin 2024. Kjo strukturë do të vazhdojë të përdoret për Parashikimet e ardhshme të Flukseve të Likuiditetit.

Numri i instrumenteve për menaxhimin aktiv të likuiditetit u rrit me futjen e dy instrumenteve të reja.

1- Depozitë në Euro, dhe

2- Konvertimi i monedhave nga lekë në dollarë dhe SDR.

Këto instrumente kanë qenë të larmishme për të siguruar menaxhim aktiv të likuiditetit për të përmbushur detyrimet e qeverisë, të tilla si SWAP (2 x 120 milionë euro), Outright (60 milionë euro në lekë) dhe depozitat. Në vitin 2024, dy instrumentet e reja të prezantuara: 1- Depozita në euro dhe 2- Konvertimi i monedhës (nga bilanci i LLUTH-së në lekë në monedhat: USD dhe SDR) **u përdorën për herë të parë**. Kjo u mundësua nga dy rishikime të marrëveshjes midis Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë mbi instrumentet e menaxhimit të likuiditetit: Rishikimi i parë: shkresa me numër protokolli Nr. 3293 i Ministrisë së Financave, datë 11 Mars 2024 dhe Rishikimi i dytë: shkresa me numër potokolli Nr. 12574 i Ministrisë së Financave, datë 27 Qershor 2022.

Masat dhe aktivitetet

Në vitin 2024 janë bërë përmirësime të rëndësishme për të përmirësuar procesin e parashikimit të likuiditetit. Në këtë drejtim, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit nisi zhvillimin e një mjeti të përbashkët të dosjeve Makro-Excel në bashkëpunim me Institucionet Buxhetore (IB) me buxhet më të lartë (institucione pilot) për përditësimet ditore të parashikimit të fluksit të likuiditetit. Ky "mjet" i zhvilluar nga FMN-ja duke përdorur Microsoft Excel është projektuar për të përgatitur parashikime dhe për të lehtësuar analizën e të dhënave. Ai do të vazhdojë të përmirësohet dhe të përdoret në vitet në vijim. Përveç kësaj, një mekanizëm njoftimi dy javë përpara se të kryhen pagesa të mëdha është miratuar si pjesë e udhëzimeve plotësuese për zbatimin e buxhetit të vitit 2024.

Rishikimi i procesit të përgatitjes dhe dorëzimit të planeve të thesarit nga institucionet buxhetore nuk u realizua sikurse planifikuar në vitin 2024 për shkak të ndryshimeve në staf. Drejtuesi i Sektorit të Menaxhimit të Likuiditetit u largua nga Ministria. Specialisti përgjegjës në këtë sektor u transferua në Drejtorinë e Përgjithshme të Programimit Makroekonomik dhe Fiskal (DPPMF) në Ministrinë e Financave. Edhe pse u caktuan zëvendësime të përkohshme dhe stafi i ri aktualisht po i nënshtrohet trajnimit, këto ndryshime ndikuan në procesin e planifikimit të thesarit. Si rezultat, Tabela e Ndarjes së Fluksit të Likuiditetit

2024 u përpilua në baza mujore duke përdorur një qasje nga lart-poshtë në vend të metodologjisë së planifikuar nga poshtë-lart. Për të adresuar këto sfida Asistenca teknike e FMN-së do të trajnojë stafin e Institucioneve Buxhetore (BI) për përditësimin e parashikimeve ditore të fluksit të likuiditetit duke përdorur mjetin e ri të dosjes së përbashkët Macro-Excel dhe menaxhimin me një qasje nga poshtë-lart. Për të ndihmuar këtë proces të rëndësishëm, në vitin 2024 ishte planifikuar të krijohet një Komitet Teknik dhe të organizoheshin takime teknike mujore me institucionet kryesore (institucionet më të mëdha buxhetore, autoritetet tatimore dhe doganore) për të marrë informacion të rëndësishëm në kohë reale. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Teknik për Parashikimin dhe Menaxhimin e Fluksit të Likuiditetit është hartuar dhe do të konfirmohet me asistencën teknike të FMN-së në mars 2025.

Është bërë përparim i konsiderueshëm në krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës të monitorimit të performancës për parashikimin e likuiditetit. Zhvillimet kryesore përfshijnë analizën e devijimit për hyrjet, daljet dhe bilancit të Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (LLUTH) i cili tashmë matet, monitorohet dhe paraqitet në Komitetin e Menaxhimit të Likuiditetit dhe Borxhit (KMLB). Treguesit Kryesorë të Performancës (TKP) janë përfshirë në legjislacionin aktual dhe raportohen pjesërisht duke përdorur metodologjinë e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) brenda dokumentacionit vjetor "Buxheti Aktual i vitit". TKP-të u diskutuan në eventin PEMPAL në Tiranë (4-6 nëntor 2024) duke ofruar një mundësi për të mësuarit e asistuar nga kolegët. Në vitin 2024, menaxhimi i likuiditetit u forcua me futjen e dy instrumenteve të reja:

1. Depozita në EUR

2. Konvertimi i monedhës (nga bilanci i LLUTH në LEKË në USD dhe SDR)

Politika e rezervave monetare u përmirësua dhe u miratua në udhëzimet plotësuese për zbatimin e buxhetit të vitit 2025. Përveç kësaj, shuma dhe afati kohor për investimet e depozitave të likuiditetit në Bankën e Shqipërisë (BOA) u rritën përmes një rishikimi të marrëveshjes së menaxhimit të likuiditetit midis Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë.

Objekti i Specifik 4.6 Menaxhimi i Aseteve

Treguesit e Performancës

Në fushën e menaxhimit të aseteve, puna për krijimin e kuadrit të përshtatshëm rregullator për vlerësimin dhe inventarizimin e pasurive publike dhe për përgatitjen e një regjistri të konsoliduar të aseteve në institucionet qendrore, në nivel njësie kontrolluese nuk avancoi sikurse planifikuar në vitin 2024. Objekti i strategjik përfundimtar i reformës është përgatitja e pasqyrave financiare të institucioneve të sektorit publik bazuar në SNKSP të përzgjedhura. Pas finalizimit të fazës së parë të projektit të kontabilitetit të sektorit publik në dhjetor 2022, gjatë vitit 2023 është hartuar koncepti i projektit për zbatimin e metodologjisë së re të kontabilitetit në sektorin publik, i diskutuar me Bankën Botërore dhe SECO. Një objektiv kryesor i fazës së dytë të projektit është miratimi i ligjit të kontabilitetit të sektorit publik dhe akteve të tjera nënligjore, bazuar në SNKSP. Kjo fazë filloi në vitin 2024, me konsulentë të angazhuar në hartimin e kuadrit rregullator, duke përfshirë Ligjin e Kontabilitetit të Sektorit Publik, udhëzimet dhe manualët e transaksioneve financiare, në përputhje me SNKSP.

Masat dhe aktivitetet

Gjatë vitit 2024, ka filluar puna për rishikimin dhe ndryshimin e metodologjisë përkatëse për menaxhimin e aseteve në përputhje me kërkesat e SNKSP me fazën e dytë të projektit SNKSP. Kjo fazë filloi në vitin 2024, me konsulentë të angazhuar në hartimin e kuadrit rregullator, duke përfshirë Ligjin e Kontabilitetit të Sektorit Publik, udhëzimet dhe manualët e transaksioneve financiare, në përputhje me SNKSP.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka vazhduar përpjekjet e saj për të lehtësuar migrimin dhe futjen e të dhënave të aseteve në SIFQ nga Institucionet Buxhetore online dhe për të kryer kontrollet e nevojshme. Gjatë vitit 2024, të dhënat për asetet fikse u migruan me sukses në mjedisin live të SIFQ për 2 institucionet me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ (Bashkia e Elbasanit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës - Kanalizimeve).

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm

Janë identifikuar disa sfida në përmirësimin e Statistikave të Financave Qeveritare (SFQ) dhe Procedurave të Deficitit të Tejkualuar (PDT) në përputhje me standardet e BE-së, të tilla si: i) Disponueshmëria e kufizuar e të dhënave të konsoliduara mbi PPP-të dhe koncesionet; ii) Vonesa në zbatim në mbledhjen dhe strukturimin e të dhënave; iii) Baza e të dhënave për koncesionet dhe PPP-të është ende në fazën e saj të hershme të zhvillimit. Përmirësimi në procesin e parashikimit të likuiditetit është ndikuar nga sfidat e personelit, veçanërisht për shkak të pozicioneve të drejtuesit të Sektorit të Menaxhimit të Likuiditetit. Për të adresuar këtë, Ministria e Financave ka marrë masa të përkohshme për të plotësuar vendet e lira, si dhe asistencë teknike e FMN-së do të trajnojë stafin përgjegjës të IB-ve për përditësimin e parashikimeve ditore të fluksit të likuiditetit duke përdorur mjete të reja (një dosje e përbashkët Makro-excel). Plotësimi i këtyre vendeve të lira dhe trajnimi i stafit mbi qasjen e re do të ndihmojë në krijimin e Komitetit Teknik dhe për të organizuar takime teknike në baza mujore me IB-të më të mëdha, Tatimet dhe Doganat, për të marrë informacion të rëndësishëm në kohë reale. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Teknik për Parashikimin dhe Menaxhimin e Fluksit të Likuiditetit është hartuar dhe pritet të konfirmohet nga asistencë teknike e FMN-së në mars 2025. Aktivitetet që lidhen me fillimin gradual të zhvillimit të vlerësimit të nevojshëm për instrumentet e reja alternative të financimit ((Instrumente të Gjelbra, Sociale ose të Qëndrueshmërisë ose të tjera) nuk filluan në vitin 2024 për shkak të vonesës dhe disponueshmërisë së asistencës teknike dhe përfshirjes së kapaciteteve të duhura njerëzore.

3.5 Progresi në Shtyllën 5 “Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik”

Sistemi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik është profesionalizuar më tej në të gjitha Institucionet Buxhetore në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat e integritetit në BE. Deri në fund të vitit 2024, 75% e objektivave të TP-ve janë arritur, 8% janë arritur pjesërisht dhe 17% e objektivave të TP-ve nuk janë arritur ende. Tabela e mëposhtme paraqet statusin e arritjes së treguesve të performancës të Shtyllës 5: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik.


Tabela 6: Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 5

Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2024	Vlera faktike 2024
Objektivi Specifik (Komponenti) 5.1 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli				
1	Përqindja e Institucioneve Publike që përmbushin kërkesat e MFK-së.	69% (2022)	72%	72.62%
2	Përqindja e institucioneve publike që kanë të vendosur mekanizma adekuat të llogaridhënies menaxheriale.	68% (2022)	72%	73.09%
3	Ligji dhe aktet nënligjore të MFK-së janë ndryshuar dhe miratuar.	NA	Metodologjia e vlerësimit të cilësisë së KB është miratuar	Metodologjia e vlerësimit të cilësisë së KB është rishikuar dhe miratuar
4	Përqindja e institucioneve publike që kanë adoptuar të gjitha mjetet e menaxhimit të riskut.	68% (2022)	72%	73.23 %
Objektivi Specifik (Komponenti) 5.2 Auditimi i Brendshëm				
1	Numri i institucioneve publike që mbulohen nga auditimet e brendshme vjetore.	136	Trend rritës	143
2	Numri i institucioneve publike që kanë një komitet funksional auditimi.	6	Trend rritës	9

3	Përqindja e audituesve të brendshëm aktivë që janë plotësisht të certifikuar ³⁶ .	80%	Trend rritës	76%
4	Përqindja e njësive të auditimit të brendshëm që kanë krijuar dhe zbatuar PPSC në përputhje me standardet në fuqi.	52%	Trend rritës	87%
5	Përqindja e audituesve të brendshëm që përputhen me kërkesat e ZHVP.	100%	100%	118%
Objektivi Specifik (Komponenti) 5.3 Inspektimi Financiar Publik dhe Shërbimet e Koordinimit kundër Mashtrimit				
1	Strategjia Kombëtare Kundër Mashtrimit (SKKM) për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së është miratuar dhe monitoruar.	-	SKKM Përgatitur/ miratuar	SKKM hartuar
Objektivi Specifik (Komponenti) 5.4 Menaxhimi i Fondeve të BE-së				
1	Hartohet dhe miratohet paketa për marrjen e besimit IPA-III.	-	Miratohet paketa për marrjen e besimit IPA-III	Paketa për marrjen e besimit IPA-III miratuar nga KE
2	Prezantohet Udhëzuesi për përshtatjen dhe rikuperimin (UPR) të fondeve të BE-së.	-	UPR miratohet	UPR nuk është miratuar

Progres i kënaqshëm është bërë edhe në drejtim të zbatimit dhe përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2024. Shumica (78%) e aktiviteteve ishin në rrugën e duhur ose të përfunduara, ndërsa pjesa e mbetur prej 22% e aktiviteteve u vlerësuan si pjesërisht në rrugën e duhur ose që nuk kanë filluar akoma.

Grafiku 11: Statusi për vitin 2024 të aktiviteteve në Shtyllën 5



Progresi i komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2024

Objektivi Specifik 5.1 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

Treguesit e Performancës

³⁶ Të gjithë audituesit e brendshëm duhet të certifikohen brenda 3 viteve, sipas Ligjit.

Të gjitha objektivat e Treguesve të Performancës të vendosura për MFK-në u arritën plotësisht në vitin 2024. Përqindja e Institucioneve Publike që përmbushin kërkesat e MFK-së është 72.62% kundrejt objektivit prej 72%. Fokusi kryesor ishte në përmirësimin e funksionalitetit të sistemit të MFK-së përmes ofrimit të asistencës teknike dhe vlerësimit të cilësisë së kontrollit të brendshëm dhe progresit të sistemit të kontrollit të brendshëm, duke inkurajuar angazhimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me rëndësinë strategjike dhe operacionale të zbatimit të instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Nga analiza e detajuar e 17 parimeve të kontrollit të brendshëm, rezultoi se sistemi i kontrollit të brendshëm për vitin 2024 është pjesërisht efektiv. Komponentët e vlerësimit të mjedisit të kontrollit dhe aktiviteteve të kontrollit vazhdojnë të tregojnë një vlerësim më të kënaqshëm. Konkretisht, zbatimi i vlerësimeve të cilësisë së MFK-së në institucionet publike dhe ofrimi i asistencës teknike ka rritur ndërgjegjësimin e menaxherëve dhe stafit për njohjen dhe zbatimin e instrumenteve të MFK-së. Rekomandimet e dhëna në raportet e vlerësimit kanë shërbyer si pikënisje e mirë për hartimin e planeve të veprimit në nivelin e institucioneve publike. Këto plane theksojnë masat për adresimin e mangësive dhe ndjekjen e vazhdueshme të tyre dhe kontribuojnë në përmirësimin e mekanizmave të monitorimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Përqindja e institucioneve publike që kanë mekanizma adekuate të llogaridhënies manaxheriale është rritur në 73.09% në vitin 2024 kundrejt objektivit 72%. Këto institucione kanë miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë, natyrën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre. Këto institucione kanë përcaktuar deklaratat e misionit dhe objektivat e tyre strategjike dhe operacionale, pjesë e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), duke krijuar një lidhje organike midis këtyre prioritetëve dhe objektivave të performancës. Në hartimin e PBA-së janë të përfshirë të gjithë drejtuesit e programit, të cilët analizojnë situatën dhe përcaktojnë, monitorojnë dhe raportojnë prioritetet dhe objektivat që duhen realizuar. Në të njëjtën kohë, vërehet një mungesë e raportimit të rregullt periodik dhe zbatimit të masave konkrete për adresimin e çështjeve që lidhen me sistemin e kontrollit të brendshëm. Kjo tregon nevojën për hartimin e një sistemi procedurash për krijimin, zbatimin dhe raportimin periodik të standardeve tek drejtuesit apo strukturat e tjera të institucionit. Fokusi i kuadrit aktual të raportimit mbetet në ofrimin e informacionit për performancën financiare, si raportet e monitorimit të buxhetit apo raportet mbi detyrimet financiare, dhe më pak në përgatitjen e raporteve periodike për ecurinë dhe statusin e zbatimit të objektivave të vendosura ose çështjeve që lidhen me sistemet e kontrollit të brendshëm. Një mekanizëm tjetër i rëndësishëm për funksionimin e një sistemi efektiv të përgjegjësisë manaxheriale është përdorimi i procedurave të rregullta për delegimin e detyrave dhe përgjegjësisë. Ky element është zbatuar pak dhe vlerësohet si i pakënaqshëm. MF-ja mbështet institucionet në zbatimin e instrumenteve të llogaridhënies manaxheriale, nëpërmjet kuadrit rregullator apo asistencës teknike, si dhe nëpërmjet rekomandimeve të dhëna gjatë vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe trajnimeve. Mangësitë e evidentuara në këtë aspekt lidhen kryesisht me mungesën e ndërgjegjësimit për të kuptuar rëndësinë e tij si dhe me përcaktimin e qartë të termave, rregullave dhe procedurave që duhen ndjekur në procesin e delegimit të detyrave brenda njësisë publike.

Ministria e Financave (DHMFKK) vazhdoi të përmirësojë kuadrin ligjor dhe rregullator për MFK-në. Sipas raportit vjetor të monitorimit të MFP-së për vitin 2023, manuali i MFK-së u ndryshua me Urdhrin Nr. 4 të Ministrit të Financave më 26 janar 2024. Përveç kësaj, Udhëzimi mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike u rishikua me udhëzimin Nr. 2, të lëshuar në të njëjtën datë. Për më tepër, metodologjia e vlerësimit të cilësisë së Kontrollit të Brendshëm (KB) u rishikua dhe u miratua me Urdhërin Nr. 159, datë 18 tetor 2024, duke përfshirë përmirësime procedurale dhe duke zgjeruar fushëveprimin e saj për të përfshirë ndërmarrjet shtetërore. Këto rishikime përputhen me ndryshimet në Ligjin Nr. 10296, datë 8 korrik 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", të ndryshuar. Gjithashtu, udhëzimi për koordinimin e riskut dhe koordinimin e MFK-së u ndryshua me udhëzimin Nr. 16, datë 31 dhjetor 2024 mbi koordinimin e MFK-së dhe grupin e menaxhimit të riskut.

